



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

Nr. 202 /12-15 Prot.

Tiranë, më 21.09.2021

Miratohet

**Raport Përfundimtar
Auditimi Performance
“MANAXHIMI I MBETJEVE
PLASTIKE”**

KRYETAR

ARBEN SHEHU



Y. P.

Drejtor i Departamentit

Publik: Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin 154/2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, specifikisht nenin 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: +355 4 2247294

Auditimi është kryer në bazë të shkresës informuese Nr. 202, datë 04.02.2021 dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, 202/4 datë 19.04.2021.

Auditimi me temë “Menaxhimi i mbetjeve plastike”, ka mbuluar periudhën 2017-2020 dhe është fokusuar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si ministria përgjegjëse në hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me menaxhimin e mbetjeve plastike si dhe në Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë duke qenë se institucionet e vetëqeverisjes vendore kanë një sërë përgjegjësish lidhur me menaxhimin e mbetjeve plastike. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresat me protokoll nr. 202/5; nr. 202/6; nr. 202/7 dhe nr. 202/8, datë 30.06.2021, iu përcoll Projekt-Raporti i Auditimit subjekteve të audituara.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka dërguar komentet e saj mbi projekt-raportin me anë të shkresës nr. prot. 4556/1, datë 06.08.2021, të cilat grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje argumentimet dhe komentet e subjekteve dhe i reflektoi ato në raportin përfundimtar.

Subjektet e tjera të audituara, Bashkia Tirane, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Elbasan, nuk paraqitën observacion mbi me gjetjet dhe rekomandimet e Projekt Raportit.

Ky Raport është hartuar në përputhje me standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës e konkretisht: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI, Udhëzuesin e Auditimit të Performancës ISSAI 3000 – 3100, Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës, si dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në konsultë të vazhdueshme me stafin e institucioneve, subjekte auditimi, intervistat, përvojën më të mirë audituese në këtë fushe, etj.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

1. A.G.(Përgjegjës Grupi)
2. E.K.(Anëtare)
3. S.J.(Anëtare)

Procesi auditues u mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme nga drejtori i departamentit.

Dosja audituese kaloi në procedurën e Kontrollit të Cilësisë dhe më pas iu përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.

PËRMBAJTJA

1. Problemi Social dhe Rëndësia e Auditimit	4
1.1 Konteksti i Problemit Social	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	6
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë	7
2. Subjekti/et nën auditim	8
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim	8
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim	12
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit	13
2.4 Pesha në buxhet	14
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia	18
2.6 Skema e analizës së programit	19
2.7 <i>Feedback</i> -u i subjektit në fazën studimore	21
3. Detajet e auditimit	21
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	21
3.2 Objektivat e auditimit	23
3.3 Pyetjet e auditimit	24
3.4 Fushëveprimi i auditimit	25
3.5 Kriteret	25
3.6 Qasja/metodologjia e auditimit	28
4. Shtjellimi i pyetjeve dhe nënpyetjeve	36
5. Përmbledhja	73-74

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Fjala “plastikë” në fillim kishte kuptimin "e qëndrueshme dhe që merr formë lehtësisht". Vetëm kohët e fundit është shndërruar në një emër për një kategori të caktuar materialesh të quajtur polimerë. Përgjatë dy shekujve të kaluar njerëzit mësuuan si të krijojnë polimerë sintetikë, ndonjëherë duke përdorur substanca natyrore si celulozë, por më shpesh duke përdorur atomet e karbonit të bollshëm të siguruar nga nafta dhe karburantet e tjera fosile.

Polimeri i parë sintetik u krijua në vitin 1869 nga John Wesley Hyatt, që duke trajtuar celulozën e nxjerrë nga fibra e pambukut, zbuloi një plastikë që mund të përgatitej në një larmi formash dhe mund të imitonte substanca natyrore tejet të kushtueshme dhe të vështira për t'u përfutur. Ky zhvillim ndihmoi jo vetëm njerëzit por edhe mjedisin. Plastikatat mund të mbronin botën natyrore nga forcat shkatërruese të nevojës njerëzore.¹ Mirëpo optimizmi për plastikën nuk zgjati sa u mendua në fillim. Mbetjet plastike në oqeanë u vërejtën për herë të parë në vitet 1960, një dekadë në të cilën njerëzit filluan të ndërjegjësohen gjithnjë e më shumë për problemet mjedisore dhe për rezistencën e jetëgjatësinë e mbetjeve plastike në natyrë.

Reputacioni i plastikës ra më tej në vitet 1970 dhe 1980, ndërsa ankthi për mbetjet u rrit. Plastika u bë një objektiv i veçantë sepse, duke qenë një nga materialet më të përhapura në ekonomi është dhe ndër ndotësit më të përhapur e më rezistentë në planet. Ajo është bërë pjesë e pashmangshme e botës së materialeve, që rrjedh vazhdimisht përmes përvojës njerëzore në gjithçka, që nga shishet plastike, çantat, paketimi i ushqimeve, veshmbathjet, pjesët e makinave, materialet e ndërimit, etj. Në këtë pikë, ishte vetë industria e plastikës që ofroi e para riciklimin si zgjidhje të problemit. Sidoqoftë, riciklimi është larg nga të qenit një zgjidhje përfundimtare, dhe shumica e plastikës akoma përfundon në landfill dhe mjedis. Prodhimi global i plastikës është rritur nga 2 milionë ton në vitin 1950, në 380 milionë ton në vitin 2015.²

Në Bashkimin Evropian, sektori i plastikës punëson rreth 1.5 milionë njerëz duke gjeneruar rreth 340 miliardë € të ardhura vetëm për vitin 2015. Rreth 25.8 milion ton mbeturina plastike gjenerohen në Evropë çdo vit. Më pak se 30% e mbeturinave të tilla mblidhen për riciklim. Sipas vlerësimeve, 70-105 miliardë € humbasin në ekonomi si rezultat i trajtimit dhe asgjësimit të plastikës nëpërmjet “*landfill*”-eve dhe *inceneratorëve*.³ Të dhëna të tilla në Shqipëri janë thuajse inekzistente për shumë arsye dhe një pjesë e tyre do të trajtohen edhe gjatë këtij auditimi.

Është vlerësuar se prodhimi i plastikës dhe djegia nëpërmjet inceneratorëve të mbetjeve plastike në nivel global krijojnë rreth 400 milionë ton dioksid karboni (CO₂) në vit. Riciklimi i plastikës mund zvogëlojë varësinë nga shfrytëzimi i lëndëve fosile për prodhimin e plastikës dhe të frenojë emetimin e CO₂. Sipas vlerësimeve, potenciali nga riciklimi i të gjitha mbeturinave plastike globale është ekuivalent me 476 milion tonë naftë në vit.

Burime të reja të rrjedhjeve plastike janë gjithashtu në rritje, duke paraqitur kërcënime të mundshme shitesë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut së bashku. Mikroplastika ose fragmente të vogla plastike me madhësi nën 5 mm grumbullohen në det dhe madhësia e tyre e vogël i bën ato të lehta për gjallesat detare që t'i gllabërojnë ato. Ato gjithashtu mund të hyjnë në zinxhirin ushqimor. Në total, vlerësohet se çdo vit në mjedisin e Bashkimit Evropian lëshohen nga 75,000 deri 300,000 ton mikroplastikë⁴.

¹ <https://www.sciencehistory.org/the-history-and-future-of-plastics>

² <https://www.statista.com/topics/5401/global-plastic-waste/>

³ A European Strategy for Plastics in a Circular Economy, European Commission, fq 6.

⁴ A European Strategy for Plastics in a Circular Economy, European Commission, fq 8.

Figura 1: Përfitimet e riciklimit të plastikës në kursimin e CO₂



Burimi: A European Strategy for Plastics in a Circular Economy, European Commission

Figura 2: Cikli i jetës së plastikës



Punuar nga grupi i Auditimit; Burimi i informacionit: World Wild Fund

Në vitin 2015 konsumi global i plastikës ishte 45 kg / banor⁵. Për shkak se plastika nuk shpërbëhet në mjedis, ajo ka vazhduar të grumbullohet në rrugët ujore, tokat bujqësore, lumenjtë, detet dhe oqeanet për dekada të tëra. Vitet e fundit është vënë re një vetëdije dhe shqetësim në rritje për krizën urgjente të plastikës në oqeanet. Ky shqetësim është zgjeruar edhe me ndikimin e plastikës në ekosisteme, furnizimin me ushqim, me ujë, si dhe në shëndetin e njeriut, në mes të dëshmimeve të reja se plastika po grumbullohet jo vetëm në mjedis por edhe në trupin tonë⁶.

⁵ <https://www.statista.com/topics/5401/global-plastic-waste/>

⁶ Plastic & Climate; The Hidden Costs of a Plastic Planet - www.ciel.org/plasticandclimate

Figura 3: Dhjetë produktet plastike më të përdorshme



Punuar nga grupi i auditimit; Burimi i informacionit: European Commission

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës


Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtëjshëm. Misioni i KLSH-së si një institucion i pavarur kushtetues, është t'i shërbejë qytetarit shqiptar, duke qenë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit⁷.

Kontrolli i Lartë i Shtetit prej disa vitesh është anëtar aktiv i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit (EUROSAT WGEA) dhe në këtë kuadër kryerja e auditimeve që kanë në fokus çështjet e mjedisit është gjithmonë e përfshirë në planin vjetor të auditimeve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit angazhohet në kryerjen e këtij auditimi si një projekt i ndërmarrë nga 14 Institucione Supreme Auditimi në Evropë. Auditimi është iniciuar nga SAI Polak me moton: “Plastika, një problem i përbashkët, pse jo një auditim i përbashkët”.

Problemi i mbetjeve plastike, por jo vetëm, është një çështje e nxehtë në Shqipëri prej më shumë se dy dekadash. Shqipëria nuk ka një infrastrukturë të ngritur të menaxhimit të mbetjeve, nuk ndjek sistemin e piramidës së përmbysur të menaxhimit të mbetjeve dhe është akoma në nivelin e fundit të saj për sa i takon mënyrës së menaxhimit (figura 4).

Figura 4. Hierarkia e Menaxhimit të Mbetjeve



⁷ Vendim i Kryetarit të KLSH nr. 229, datë 31.12.2017 “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH- së për Periudhën 2018 – 2022”.

Opsioni më i preferuar është në pjesën e sipërme të piramidës së përmbysur (parandalimi/reduktimi) dhe ai më pak i preferuar, në pjesën e poshtme të saj (depozitimi i mbetjeve në landfill).

Në vendin tonë nuk ka të dhëna të sakta për mbetjet plastike në veçanti duke qenë se mbetjet nuk ndahen në burim dhe nuk trajtohen në mënyrë të ndarë. Lidhur me problemet në menaxhimin e mbetjeve Progres Raporti i KE-së për vitin 2019 shkruan: “Në Shqipëri nuk kryhet ndarja e mbetjeve sipas rrymave të ndryshme, vetëm 65% e mbetjeve të prodhuara mblidhen, nuk ka praktika për riciklimin e mbetjeve, instrumentet ekonomike që promovojnë riciklimin dhe parandalimin e prodhimit të mbetjeve janë të limituara”.

Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve ka qenë edhe më herët në fokus të auditimeve të KLSH-së por në këtë auditim do të fokusohemi vetëm në një rrymë, atë të *Mbetjeve Plastike*. Nisur nga sa u përmend më lart rëndësia e këtij auditimi do të qëndrojë në faktin se do të bëhet një vlerësim i situatës aktuale të menaxhimit të mbetjeve plastike në vendin tonë, do të shikohet sa në harmoni është kuadri rregullator i Shqipërisë për mbetjet plastike me atë të BE-së, dhe në përfundim nisur dhe nga fakti që është një auditim i koordinuar me institucionet homologe në Evropë do të sjellë edhe një praktikë të mirë nga vendet e BE-së në trajtimin e mbetjeve plastike.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Auditimet e performancës që janë kryer nga KLSH në fushën e mjedisit gjatë viteve të fundit kanë pasur një rritje të konsiderueshme në numër dhe në cilësi. KLSH duke qenë edhe pjesë e EUROSAI dhe INTOSAI Working Group on Environment Audits ka rritur fokusin e saj për auditimet me perspektivë mjedisore duke përfshirë gjithnjë në planin vjetor të punës temat që kanë ndikim në mjedis. Dhe është pikërisht ky fokus i KLSH-së që vjen në këtë angazhim të ri mbi çështjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve. KLSH ka kryer edhe më parë auditime në fushën e mbetjeve, edhe pse jo në mënyrë specifike për mbetjet plastike. Disa nga auditimet e performancës të kryera nga KLSH në vite, që kanë lidhje direkt me menaxhimin e mbetjeve janë:

✓ Auditimi i Performancës me temë “*Menaxhimi i përpunimit të mbetjeve të ngurta në impiantin e bashkisë Fier*”, i kryer në vitin 2018. Mesazhi i këtij auditimi ishte: “Në zhvillimin e projektit për incenerimin e mbetjeve urbane për përfitim të energjisë, palët e interesit janë konsultuar në mënyrë formale, si publiku, i cili ka qenë vazhdimisht kundër, dhe institucionet zyrtare lokale të cilat nuk kanë dhënë mendimin e tyre profesional dhe nuk kanë përfaqësuar publikun e tyre, por projekti është vendosur për t’u zhvilluar pavarësisht kësaj situate. Projekti është ngritur dhe po ecën përpara duke krahasuar vetëm 2 alternativa, atë ekzistente pa projekt dhe atë që mund të jetë sipas këtij projekti. Gjatë zgjedhjes së kësaj alternative nuk janë konsideruar alternativa të tjera të mundshme, duke anashkaluar proceset e ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve, e duke mos zbatuar kësaj Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve”⁸.

✓ Auditimi i performancës me temë “*Menaxhimi i Mbetjeve Urbane në Bashkinë e Tiranës*”, i kryer në vitin 2016. Disa nga gjetjet kryesore të këtij auditimi janë⁹:

Nëpërmjet kontraktimit të operatorëve ekonomikë për menaxhimin e mbetjeve urbane Bashkia e Tiranës:

- Nuk ka arritur objektivat në drejtim të shërbimit të popullatës dhe ruajtjes së mjedisit në territorin e saj.
- Kuadri rregullator në zbatim të Strategjisë Kombëtare dhe akteve ligjore bashkëkohore të miratuara nuk është i përditësuar dhe si rrjedhojë objektivat nuk janë të qarta e të përcaktuara mirë.
- Edukimi publik në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin e mbetjeve, nga ana e strukturave të bashkisë dhe operatorëve ekonomikë ka

⁸ Vendim Nr. 236 Datë 21.12.2018 http://www.klsh.org.al/web/09_inceneratori_fier_4702.pdf

⁹ Raporti Përfundimtar i auditimit “*Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë e Tiranës*”.

patur mangësi të theksuara, nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe nuk ka dhënë ndonjë impakt të ndjeshëm social, për mbajtjen pastër të qytetit dhe për ndarjen e mbetjeve në burim për riciklim.

- Vend depozitimi i mbetjeve në zonën e Sharrës nuk plotëson kushtet e parametrat e një landfilli bashkëkohor me parametra të lartë mjedisore si dhe ka tejkaluar afatin e përdorimit dhe kapacitetet e përpunimit.
- Mungesa e një Strategjie të Menaxhimit të Mbetjeve nga bashkia, ka ndikuar në menaxhimin e mbetjeve, me një infrastrukturë të dobët, me kontejnerë të amortizuar, të pambyllur, larg zbatimit të kuadrit ligjor për ndarjen në burim të mbetjeve; niveli teknik i makinerive teknologjike transport, fshirje, larje, etj.

✓ Auditimi i performancës me temë: “Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në rastin e bashkisë Fier”, i kryer në vitin 2013. Disa nga rekomandimet e këtij auditimi janë¹⁰:

- Bashkia Fier në shërbim të qytetarëve e mbrojtjes së mjedisit të zbatojë strategjitë afatmesme e afatgjata për parandalimin e ndotjes dhe të marrë masa të forta për të nxitur zgjedhjen e opsionit më të mirë për minimizimin e mbetjeve.
- Bashkia Fier duhet të nxisë realizimin e modelit të ndarjes në burim të mbetjeve urbane sipas një kompozimi “praktik” të koshit të riciklimit.
- Të miratohet në Këshillin Bashkiak të Qytetit të Fierit Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane i hartuar në vitin 2010 dhe të fillojë zbatimi i tij.
- Bashkia Fier në bashkëpunim me donatorët të hartojë programe efektive për edukimin e publikut (komuniteti, shkollat) në drejtim të çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin e tyre, duke siguruar bashkëpunimin me qytetarët dhe sektorin privat.

2. Subjekti/et nën auditim

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Institucionet që do të përfshihen në auditimin me temë “Menaxhimi i Mbetjeve Plastike” janë:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit institucion në varësi të MTM-së;
- Njësitë e Qeverisjes Vendore;
 - Bashkia Tiranë
 - Bashkia Vlorë
 - Bashkia Elbasan

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit mbështetur në legjislacionin në fuqi është institucioni përgjegjës për zbatimin e programit të qeverisë për mjedisin, për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave mjedisore dhe të menaxhimit të integruar të mbetjeve.


Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion në varësi të MTM-së e krijuar me VKM nr. 47, datë 29.1.2014¹¹.

Bashkia Tiranë, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Elbasan janë institucione që për menaxhimin e mbetjeve plastike kanë detyra dhe përgjegjësi të ngarkuara nga kuadri rregullator në fuqi për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

¹⁰ Vendimi i auditimit “Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane, Bashkia Fier”.

¹¹ VKM nr. 47, datë 29.1.2014 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”.

Figura 5: Skema e subjekteve nën auditim



(Punoi: Grupi i auditimit)

Menaxhimi i Mbetjeve Plastike në vendin tonë kryhet si pjesë e procesit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në tërësi. Ky menaxhim kryhet bazuar në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve¹², Ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, si dhe një sërë aktesh të tjera ligjore dhe nënligjore të renditura tek kriteret e auditimit. Në kontekstin e auditimit të Menaxhimit të Mbetjeve Plastike mund të veçojmë aktet nënligjore si: VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim”, VKM nr. 177, datë 6.3.2012 “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e tyre” e ndryshuar¹³ dhe VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave për Mbajtjen, Përditësimin dhe Publikimin e Statistikave të Mbetjeve”. Procesi i menaxhimit të mbetjeve plastike nuk është i ndarë nga menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane. Për këtë arsye është e vështirë që të identifikohen përgjegjësi që kanë të bëjnë vetëm me mbetjet plastike. Grupi i auditimit është përpjekur të identifikojë detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucioneve nën auditim që kanë të bëjnë me menaxhimin e integruar të mbetjeve në tërësi ku menaxhimi i mbetjeve plastike është pjesë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, është institucioni që harton Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve ku përfshihen dhe mbetjet plastike, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit. Nëpërmjet Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve, MTM nxit ripërdorimin e produkteve duke ngritur instrumentet e përshtatshme ekonomike. MTM është institucioni i cili ka përgjegjësi për të zbatuar programin e qeverisë për trajtimin e mbetjeve. Gjithashtu MTM ka detyra të tjera që i ngarkohen nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e MTM-së në procesin e menaxhimit të mbetjeve në tërësi dhe mbetjeve plastike në veçanti janë:

- Ministria harton Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit¹⁴;
- Ministria harton programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit¹⁵;

¹² VKM nr. 175, datë 19.1.2011 datë 19.1.2011 Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

¹³ VKM nr. 232, datë 26.4.2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e tyre”.

¹⁴ Ligji nr.10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 10

¹⁵ Ligji nr.10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 14

- Ministria dhe autoritetet përkatëse nxisin ripërdorimin e produkteve dhe përgatitjen e veprimtarive të ripërdorimit, në veçanti, duke nxitur ngritjen dhe mbështetjen e rrjeteve të ripërdorimit e të riparimit, përdorimin e instrumenteve ekonomike, zbatimin e kriterëve të prokurimit, arritjen e objektivave sasiorë ose marrjen e masave të tjera¹⁶;
- Ministria përgatit dhe publikon çdo 3 vjet një raport për statistikën e mbetjeve në Shqipëri¹⁷;
- Ministria përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare në mënyrë periodike dhe sipas rastit, për secilin nga përbërësit e mjedisit¹⁸;
- Ministria mbështetur në të dhënat e AKM-së, harton raportin për zbatimin e VKM-së nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim”¹⁹.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, është institucion në varësi të MTM-së dhe lidhur me Menaxhimin e Mbetjeve Plastike grupi i auditimit e ka përfshirë atë për sa i takon detyrave dhe përgjegjësi si në vijim²⁰:

- Monitoron dhe vlerëson gjendjen e mjedisit dhe përgatit Programin Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit;
- Përgatit dhe publikon Raportin për Gjendjen e Mjedisit dhe botime të tjera që kanë lidhje me mjedisin;
- Kryen kërkime shkencore që lidhen me mjedisin ose kërkime të tjera për zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionin;
- Krijon dhe menaxhon Sistemin e Informacionit Mjedisor;
- Siguron informacion mjedisor për publikun në lidhje me çështjet mjedisore;
- I rekomandon Ministrit të bëjë propozime për hartimin e akteve të reja, për ndryshime ligjore apo për çështje të tjera që lidhen me hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit.

Gjithashtu AKM ka detyra dhe përgjegjësi për sa i takon mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për menaxhimin e mbetjeve. Ku ndër më kryesoret mund të përmendim:²¹

- përpunon të dhënat në nivel kombëtar për sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar dhe objektivat e arritur,
- regjistron të dhënat në regjistrin e krijuar për këtë qëllim,
- pasqyron të dhënat në raportin e gjendjes së mjedisit,
- raporton në MTM brenda datës 28 Shkurt të çdo viti për të dhënat e grumbulluara.

Bazuar në VKM-në Nr. 687, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave për Mbajtjen, Përditësimin dhe Publikimin e Statistikave të Mbetjeve” që ka hyrë në fuqi në 1 Janar 2019, AKM mbledh, mban dhe përditëson statistikën për mbetjet sipas shtojcës nr. 1, të kësaj VKM-je.

Njësitë e Qeverisjes Vendore. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive në procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve janë të përcaktuara në legjislacionin e cituar në rubrikën e kriterëve të auditimit. *Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë*, në bazë të legjislacionit ekzistues kanë përgjegjësitë e mëposhtme sa i takon menaxhimit të mbetjeve ku mbetjet plastike janë pjesë:

- Çdo bashki ka si funksion të vetin kryerjen e procesit të grumbullimit, largimit dhe përpunimit të mbetjeve²²;
- NJQV-të përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e hartuara nga MTM²³;

¹⁶ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 18

¹⁷ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 60

¹⁸ Ligji nr. 10431, dt. 09.06.2011, "Për Mbrojtjen e Mjedisit", neni 21

¹⁹ VKM nr. 418, datë 25.06.2014 Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim, Kreu VIII, pika 3.

²⁰ Rregullore Për Organizimin dhe Veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

²¹ VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të mbetjeve në Burim”.

²² Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin e qeverisjes vendore”, neni 10.

²³ Ligji nr. 10431, datë. 09.06.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, neni

- Çdo NJQV apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve²⁴;
- Çdo NJQV apo grup njësisish të qeverisjes vendore përcakton rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve, që gjenerohen në territorin e vet, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve. Këto rregulla mund të jenë më strikte sesa qëllimet dhe kërkesat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Këto rregullore miratohen nga Këshilli i Qarkut²⁵;
- Autoritetet e qeverisjes vendore përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e hartuara nga ministria²⁶;
- NJQV-të janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre dhe këto të dhëna ia dërgojnë Këshillit të Qarkut përkatës, AKM-së dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën/transportin brenda datës 31 janar, të çdo viti.²⁷
- Bashkitë e kategorisë së parë, në përputhje me përcaktimin e nenit 3, të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009, “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, përcaktojnë, brenda datës 31 Dhjetor 2016, masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të paktën për rrymat e mbetjeve të mëposhtme: Letër/karton; Metal; **Plastikë**; Qelq²⁸.
- NJQV-të, marrin, brenda 31 dhjetorit 2018, masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, të paktën për rrymat e mbetjeve të përcaktuara Letër/karton, Metal, **Plastikë** dhe Qelq²⁹;
- Çdo NJQV raporton në mënyrë periodike, brenda datës 31 Janar të çdo viti, të dhënat për grumbullimin e rrymave të mbetjeve dhe objektivat në AKM³⁰.

²⁴ Ligji nr.10463, datë 22.09.2011, "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 12, pika 2.

²⁵ Ligji nr.10463, datë 22.09.2011, "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 12, pika 3.

²⁶ Ligji nr. 10431, datë. 09.06.2011, "Për Mbrojtjen e Mjedisit", neni 22.


²⁷ VKM-në Nr. 687, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave për Mbajtjen, Përditësimin dhe Publikimin e Statistikave të Mbetjeve”.

²⁸ VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim”.

²⁹ VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim”.

³⁰ VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim”.

Figura 6: Problematikat me të cilat përballlet procesi i Menaxhimit të Mbetjeve Plastike³¹.



2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI 2015 – 2020;
- Programi i Qeverisë për Mjedisin 2017-2021;
- Strategjia Kombëtare Shqiptare për Mbetjet dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve.
- Ligj nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”;
- Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”;
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
- Ligji nr. 8480, date 25.8.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”
- Ligji nr.10119, datë 23.4.2009, “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim”;
- VKM nr. 177, datë 6.3.2012 “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e tyre”;
- VKM nr. 232, datë 26.4.2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e tyre”;
- VKM Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për Lendfillet e Mbetjeve”
- VKM nr. 389, datë 27.6.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Lendfillet e Mbetjeve”;

³¹ Problematikat potenciale që hasen në menaxhimin e mbetjeve plastike janë identifikuar nga grupi i auditimit si rezultat i shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion dhe i vlerësimit të gjëndjes aktuale.

- VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave për Mbajtjen, Përditësimin dhe Publikimin e Statistikave të Mbetjeve”;
- VKM nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”;
- VKM nr. 47, datë 29.1.2014 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”;
- VKM Nr.825, datë 13.10.2010 “Për Miratimin e Listave të Mbetjeve që Lejohen të Importohen për Qëllime Përdorimi, Riciklimi dhe Përpunimi”;
- VKM Nr. 99, datë 18 shkurt 2005 “Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve”;
- VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”;
- VKM nr. 178, datë 06.03.2012 “Për Incenerimin e Mbetjeve”;
- Plani - Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Elbasan 2019 – 2024;
- Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Rregullore për Organizimin dhe Veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Drejtorisë Rajonale të Mjedisit;
- Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë Elbasan;
- Rregullore e Brendshme Bashkia Vlorë;
- Raportet e Gjendjes në Mjedis 2017-2018;
- Progres-Raportet i Bashkimit Evropian për Shqipërinë 2017-2019.
- *European Strategy for Plastics in a Circular Economy*;
- *Directive of the European Parliament and of the Council on the Reduction of the Impact of Certain Plastic Products on the Environment*;
- *Directive 2008/98/EC of the European Parliament and of the Council on Waste and Repealing Certain Directives*;

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

I gjithë aktiviteti i subjekteve për menaxhimin e mbetjeve plastike duke të përkthehet në produkte specifike që të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës reale. Përkatësisht si produktet më të rëndësishme të subjekteve nën auditim mund të përmendim:

- Legjislacioni specifik për menaxhimin e mbetjeve plastike, i përditësuar dhe në harmoni me strategjitë dhe direktivat e BE-së për mbetjet plastike;
- Realizimi i ndarjes në burim të mbetjeve plastike;
- Reduktimi i sasisë së prodhuar të mbetjeve plastike;
- Rritja e sasisë së mbetjeve plastike që shkojnë për riciklim;
- Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për uljen e përdorimit të mbetjeve plastike, ripërdorimin dhe për dëmet që plastika sjell në jetën e tyre dhe në mjedis;
- Monitorimi i situatës aktuale dhe monitorimi i masave të marra.

Produktet e sipërpërmendura janë domethënëse për menaxhimin e mbetjeve plastike dhe përmirësimin e gjendjes si në nivel qendror ashtu dhe në nivel vendor. Një kuadër i plotë ligjor e në harmoni me kuadrin ligjor të BE-së, menaxhimi efektiv i mbetjeve nga njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të këtij kuadri, njohja e situatës nëpërmjet statistikave dhe në përfundim monitorimi i zbatimit të politikave dhe menaxhimit efektiv të mbetjeve përbëjnë një infrastrukturë funksionale dhe bashkëkohore të menaxhimit të mbetjeve në tërësi dhe atyre plastike në veçanti.

Fushatat edukuese dhe informuese janë shumë të rëndësishme pasi ato kanë të bëjnë drejtpërdrejt me rritjen e ndërgjegjësit të publikut të gjerë mbi rëndësinë e rolit të çdokujt në reduktimin e përdorimit të produkteve plastike dhe rrjedhimisht të mbetjeve plastike. Ndërgjegjësimi ka rëndësi edhe për rritjen e njohurive në lidhje me dëmin që sjellin mbetjet plastike, duke e nisur që nga

jetëgjatësia e tyre shumë e shkurtër në përdorim por tejet e gjatë si mbetje në mjediset tokësore dhe ujore, dhe duke përfunduar me faktin që plastika është e dëmshme, pasi është e përbërë nga kimikate që dëmtojnë trupin e njeriut.

2.4 Pesha në buxhet

Për auditimin e Menaxhimit të Mbetjeve Plastike grupi i auditimit ka shqyrtuar buxhetin e subjekteve nën auditim dhe ajo që vërehet është se në buxhet është e pamundur të identifikohen dhe vlerësohen shumat e alokuara për menaxhimin e mbetjeve plastike si objekti i këtij auditimi. Në vijim po paraqesim në vija të përgjithshme, buxhetin e secilit subjekt dhe program për periudhën objekt auditimi me disa sqarime përkatëse.


Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Tabela 1 : Buxheti i MTM-së dhe Programi Mbrojtja e Mjedisit në 000/lekë

Emërtimi Buxhetor`	2017		2018		2019		2020	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I. Programi "Mbrojtja e Mjedisit"	2,697,689	2,473,979	963,762	794,738	884,170	762,706	987,373	884,288
II. MTM Buxheti Total	3,859,539	3,333,413	2,279,121	1,981,131	2,732,490	2,243,817	2,719,929	2,404,166

(Burimi: MTM/ Raporti i shpenzimeve sipas programeve buxhetore 2017 -2020)

Grafiku nr. 1



Planifikimi buxhetor për hartimin dhe miratimin e projekteve në sektorin e menaxhimit të mbetjeve për periudhën objekt auditimi ka përbërë 74.22% të buxhetit faktik të ministrisë në vitin 2017, 40.12% në vitin 2018, 33.99 % në vitin 2019 dhe 36.78% në vitin 2020. Planifikimi buxhetor i kësaj ministrie paraqet rënie të mbështetjes financiare për përmirësimin e kushteve për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Tabela 2: Investime të brendshme dhe të huaja lidhur me menaxhimin e mbetjeve 000/lekë


Emërtimi Buxhetor	2017		2018		2019		2020	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I. Investime të Brendshme	1,802,057	1,713,542	176,406	160,595	166,670	155,268	101,253	89,097
Inceneratori i Elbasanit	553,119	505,261						
Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier	590,000	590,000						
Studim mbi sasinë e nivelit të ndotjes në grykëderdhjet e lumenjve	110,000	112,735						
Mbyllja, rehabilitimi,					96,000	0.00		

transport i mbetjeve urbane nga vend depozitimet ilegale								
Harte e përgatitur për burimet e mbetjeve të ngurta për prodhuesit industriale (SWAN)							505	60
IPA- 2013, Mbetjet							17,008	17,008
Swan Platforma për ripërdorimin e mbetjeve							7,770	7,696
II. Investime të Huaja	418,000	319,505	310,000	245,000	215,000	151,407	409,000	389,702
IPA- 2013, Mbetjet	50,000	50,000	40,000	40,000	20,000	20,000	33,000	32,592
Mbetjet- në kuadër të ndryshimeve klimatike-GIZ	15,000	15,000	15,000	15,000	20,000	20,000	20,000	20,000
Swan Platforma për ripërdorimin e mbetjeve			1,500	1,500	834	834		
Harte e përgatitur për burimet e mbetjeve të ngurta për prodhuesit industriale (SWAN)							2,000	2,000
Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit							21,000	21,000
Totali (financ brend + financ huaj)	2,220,056	2,033,047	483,406	405,595	381,670	306,675	510,253	478,800

(Burimi: MTM/ raporti vjetor i shpenzimeve sipas programeve)

Siç mund të vërehet nga tabelat 1 dhe 2 MTM ka një zë buxhetor “Mbrotjtja e Mjedisit” dhe nga ky zë jemi përpjekur të identifikojmë ato aktivitetet të cilat kanë lidhje direkt apo indirekte me menaxhimin e mbetjeve ku mbetjet plastike janë pjesë, por nuk mund të flitet qartë për shumën që shkon për mbetjet plastike.

Grafiku nr.2



Tabelat më sipër pasqyrojnë tavanet buxhetore të përcaktuara nga Ministria e Financave për periudhën 2017 – 2020, të cilat përfshijnë edhe investimet nga burimet e huaja. Nga buxheti i shtetit janë planifikuar mbulimi i kostove lokale të tilla si pagesa e TVSH apo kosto të tjera. Ndërsa financimet e planifikuara të donatorëve janë kanalizuar pjesërisht MTM (financimi kryesor MIE), me destinacion zbatimi i projekteve të planifikuara dhe që janë në zbatim prej disa vitesh. Totali i financimeve të brendshme nga **1,802,057 mijë** lekë në vitin 2017 arrin në **101,253 mijë** lekë në vitin 2020 ose **94 % me pak** se viti 2017. Ndërsa financimet e huaja në vitin 2017 kanë qenë 418,000 mijë lekë dhe në vitin 2020 janë 409,000 mijë lekë, ose 2.15 % më pak krahasuar më vitin

2017. Sipas tavaneve buxhetore të planifikuara, trendi i buxhetit për mbështetjen e programit të mbrojtjes së mjedisit ka pësuar rënie.

Bashkia Tiranë


Burimet e financimit për vitet 2017-2020 janë të ardhura të Bashkisë Tiranë dhe të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar. Në Bashkinë Tiranë rezulton se zëri i buxhetit “Pastrimi i Qytetit” për periudhën objekt auditimi ka përbërë 11.1% të buxhetit faktik të bashkisë në vitin 2017, 10.5% në vitin 2018, 8.0 % në vitin 2019 dhe 7.71% vitin 2020. Programi “Pastrimi i Qytetit” parashikon kryerjen e shërbimeve lidhur me grumbullim, transport mbeturina urbane, larje dezinfektim kontejnerë, mirëmbajtje vendgrumbullim, fshirje dhe larje për rrugë dhe trotuare. Ky program nuk ka synuar fillimin e diferencimit të mbetjeve urbane sipas 4 rrymave dhe grumbullimin e tyre me orar dhe grafik të caktuar.

Tabela 3: Buxheti i Bashkisë Tiranë dhe buxheti për Pastrimin e Qytetit (Në 000 lekë)

Emërtimi Buxhetor	2017		2018		2019		2020	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I.Pastrimi Qytetit	1,355,799	1,078,915	1,632,403	1,462,116	1,490,374	1,382,650	1,615,956	1,396,105
II.Buxheti Total	14,731,565	9,655,411	19,103,298	13,960,551	21,269,069	17,178,177	23,635,769	18,109,529

(Burimi: Bashkia Tiranë)

Grafiku 3




Bashkia Elbasan

Burimet e financimit për vitet 2017-2020 janë të ardhura të Bashkisë Tiranë dhe të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar. Në Bashkinë Elbasan rezulton se zëri i buxhetit “Pastrimi i Qytetit” për periudhën objekt auditimi ka përbërë 6.23% të buxhetit faktik të bashkisë në vitin 2017, 5.42% në vitin 2018, 5.61 % në vitin 2019 dhe 4.85% vitin 2020. Programi “Pastrimi i Qytetit” parashikon kryerjen e shërbimeve lidhur me grumbullim, transport mbeturina urbane, larje dezinfektim kontejnerë, mirëmbajtje vendgrumbullim, fshirje dhe larje për rrugë dhe trotuare. Ky program nuk ka synuar fillimin e diferencimit të mbetjeve urbane sipas 4 rrymave dhe grumbullimin e tyre me orar dhe grafik të caktuar.

Tabela 4: Buxheti i Bashkisë Elbasan dhe Buxheti për Menaxhimin e Mbetjeve (000/lekë)

Emërtimi Buxhetor	2017		2018		2019		2020	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I. Pastrimi i Qytetit	134,818	96,700	140,210	94,192	126,708	108,747	149,247	90,476
III.Buxheti Total	2,347,039	1,551,318	2,628,183	1,736,876	2,805,591	1,938,262	2,737,418	1,867,118

Grafiku 4




Bashkia Vlorë

Në Bashkinë Vlorë rezulton se zëri i buxhetit “Menaxhimi i Mbetjeve” për periudhën objekt auditimi ka përbërë 17.29 % të buxhetit faktik të bashkisë në vitin 2017, 27.26% në vitin 2018, 16.27% në vitin 2019 dhe për vitin 2020 është 15.91%. Programi “Pastrimi i Qytetit” parashikon kryerjen e shërbimeve lidhur me grumbullim, transport mbeturina urbane, larje dezinfektim kontejnerë, mirëmbajtje vendgrumbullim, fshirje dhe larje për rrugë dhe trotuare. Ky program nuk ka synuar fillimin e diferencimit të mbetjeve urbane sipas 4 rrymave dhe grumbullimin e tyre me orar dhe grafik të caktuar.

Tabela 5: Buxheti i Bashkisë Vlorë dhe Buxheti për Menaxhimin e Mbetjeve (000/lekë)

Emërtimi Buxhetor	2017		2018		2019		2020	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I.Menaxhimi i mbetjeve	448,012	229,517	604,921	422,432	320,990	279,642	356,388	268,846
III. Buxheti Total	2,590,837	1,732,323	2,004,432	1,549,526	2,181,435	1,718,907	2,181,644	1,689,652

Grafiku 5



2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

1. “Asgjësim” është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore rikuperimin e substancave ose të energjisë.

2. *“Ambalazh”* janë të gjitha produktet e prodhuara nga çdo lloj materiali i çdo natyre, që përdoret për mbajtjen, mbrojtjen, dorëzimin, shpërndarjen dhe prezantimin e mallrave, duke filluar që nga lëndët e para e deri te produktet e përpunuara, nga prodhuesi te përdoruesi apo konsumatori.
3. *“Grumbullim”* është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.
4. *“Krijues i mbetjeve”* është çdo person, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.
5. *“Impiant bashkincinerimi”* është çdo impiant i palëvizshëm ose i lëvizshëm, qëllimi kryesor i të cilit është krijimi i energjisë ose prodhimi i produkteve materiale dhe:
 - a. që i përdor mbetjet si lëndë djegëse, bazë ose shtesë;
 - b. në të cilin mbetjet i nënshtrohen trajtimit termik, me qëllim asgjësimin e tyre.
6. *“Impiant incinerimi”* është çdo pajisje dhe njësi teknike, e palëvizshme ose e lëvizshme, që përdoret për trajtimin termik të mbetjeve, që e rikuperon ose jo nxehtësinë që krijohet nga djegia.
7. *“Lendfill”* është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë.
8. *“Mbetje shtëpiake”* janë mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që, për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.
9. *“Mbetje”* është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.
10. *“Menaxhim i Integruar i Mbetjeve”* është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.
11. *“Operator”* është personi që:
 - a. është përgjegjës për vendin e asgjësimit ose të rikuperimit të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b. kontrollon impiantin e incinerimit të mbetjeve.
12. *“Përgatitje për ripërdorim”* është kontrolli, operacionet e rikuperimit, përmes pastrimit ose riparimit, me anë të të cilave produktet ose përbërësit, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t’u ripërdorur pa iu nënshtuar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak.
13. *“Parandalim”* janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet:
 - a. sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre;
 - b. ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut;
 - c. përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.
14. *“Rikuperim”* është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:
 - a. mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar;
 - b. mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.
15. *“Riciklim”* është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t’u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t’i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.
16. *“Ripërdorim”* është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar.


17. *“Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”* është optimizimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomikisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale, pa degraduar mjedisin.
18. *“Vendndodhja e mbetjeve”* është vendi ku ndodhet lendfilli apo inceneratori apo çdo vend tjetër ku, sipas këtij ligji, lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve.
19. *“Trajtim”* janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimi.
20. *“Transportim”* është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.
21. *“Zotërues i mbetjeve”* është krijuesi i mbetjeve ose çdo person që zotëron mbetje³².

2.6 Skema e analizës së programit

Të gjitha elementët e mësipërm së bashku me promovimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e përdoruesve fundorë të energjisë nga ana e institucioneve përgjegjëse si dhe përfitimet e pritshme të projekteve në eficiencën e energjisë do të kompletojnë fokusimin tonë në këtë auditim.

³² Të gjitha përkufizimet janë bazuar në Nenin 3 të Ligjit 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

Skema 1: Analiza e Programit



Përpunoi: Grupi i auditimit

2.7 Feedback-u i subjektit

Gjatë fazës studimore, bashkëpunimi i grupit të auditimit me subjektet që janë nën auditim, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e auditimit, ka rezultuar si më poshtë:

✓ **Subjekti MTM**, për fillimin e këtij ri-auditimi ka kontaktuar me grupin e auditimit nëpërmjet z. R.B me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Mjedis. Kryerja e detyrës nga z. B në cilësinë e personit të kontaktit, ka konsistuar vetëm në përcjelljen e kërkesës së grupit të auditimit tek strukturat përgjegjëse brenda ministrisë. Në përmbushje të kësaj kërkesë grupi i auditimit ka kontaktuar dhe ka biseduar drejtpërsëdrejti me Znj. L. K, Përgjegjëse e Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Pastrimin e Mjedisit dhe Trajtimin e Mbetjeve. Dokumentacioni i kërkuar është vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga personat e sipërcituar. Bashkëpunimi me MTM në këtë fazë të auditimit, është një bashkëpunim i saktë, korrekt dhe me përgjegjshmëri profesionale.

✓ **Subjekti AKM**-institucion në varësi të MTM-së i është përgjigjur në kohë kërkesave të grupit të auditimit dhe bashkëpunimi konsiderohet pozitiv në këtë fazë të auditimit. Përkatesisht grupi i auditimit ka kontaktuar dhe ka biseduar drejtpërsëdrejti me Znj. E. Sh, Përgjegjëse e Sektorit të Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisore.

✓ **Subjekti Bashkia Tiranë** ka kontaktuar me grupin e auditimit nëpërmjet z. N. S. me detyrë Drejtor i Departamentit të menaxhimit të Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit, për fillimin e riauditimit për menaxhimin e mbetjeve plastike. Aktualisht grupi i auditimit ka dorëzuar në Bashkinë Tiranë kërkesën për vënie në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm dhe ka marrë informacion dhe dokumentacionin e kërkuar, të cilat janë në proces shqyrtimi në këtë fazë të auditimit. Bashkëpunimi me Bashkinë Tiranë në këtë fazë të auditimit, konsiderohet korrekt.

✓ **Subjekti Bashkia Elbasan**, gjatë fazës studimore dhe të terrenit të auditimit i është përgjigjur në kohë dhe me përgjegjësi grupit të auditimit për të gjithë informacionin e kërkuar. Personi i kontaktit z. A. H., Drejtor i Shërbimeve të Territorit Urban në Bashkinë Elbasan është treguar i bashkëpunues me grupin e auditimit duke na sqaruar, vënë në dispozicion të dhëna, informacione apo dokumente që kërkohen nga grupi i auditimit. Bashkëpunimi me Bashkinë Elbasan në këtë fazë të auditimit Tiranë në këtë fazë të auditimit, konsiderohet korrekt.

✓ **Subjekti Bashkia Vlorë**, i është përgjigjur në kohë grupit të auditimit, për informacionin e kërkuar duke na sqaruar, vënë në dispozicion të dhëna, informacione apo dokumente që kërkoheshin nga grupi i auditimit.

3. Detajet e auditimit

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteve të subjektit

Risqet e aktiviteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që institucionet hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Në tabelën nr. 6 më poshtë janë renditur risqet sipas fushës së aktivitetit. Janë marrë në konsideratë vetëm risqet e nivelit mesatar dhe të lartë, si dhe kemi analizuar ndikimin që kanë risqet e identifikuar në procesin e menaxhimit të mbetjeve plastike. Risqet janë identifikuar të lidhura me pyetjet e auditimit si dhe është vlerësuar niveli i vështirësisë që mund të ketë subjekti në tejkalimin e tyre. Kjo analizë rishikohet në vazhdimësi të fazës studimore të auditimit mund të rivlerësohet dhe mund të rishikohet në vazhdimësi të fazës së terrenit, në gjykim të grupit të auditimit.

Tabela nr.6: Analiza e riskut

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i Riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuara	Niveli i Riskut ³³	Pyetja e Auditimit	Lidhja dhe Realizueshmëria ³⁴
Plotësia e kuadrit ligjor	Kuadri ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në tërësi dhe menaxhimin e mbetjeve plastike në veçanti mund të mos jetë i plotë dhe i përditësuar, mund të mos jenë miratuar aktet nënligjore dhe rregullative specifike për menaxhimin e mbetjeve plastike.	- Mos menaxhim i mbetjeve plastike si një nga rrymat e mbetjeve bazuar në piramidën e menaxhimit të mbetjeve;	L	A është i plotë dhe i përditësuar kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike?	L
Harmonia e kuadrit ligjor vendas me atë të BE-së	Kuadri rregullator vendas për menaxhimin e mbetjeve plastike mund të mos jetë në harmoni me direktivat e BE-së për menaxhimin e mbetjeve plastike.	- Ndotja në rritje e mjedisit tokësor dhe ujor;	L	A është kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike në harmoni me legjislacionin e BE-së?	L
Zbatueshmëria e kuadrit ligjor	Niveli i zbatimit të legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve plastike mund të jetë i ulët.	- Ndikime negative në shëndetin e njeriut;	L	A janë marrë nisma nga bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan për zbatimin e legjislacionit lidhur me grumbullimin e ndarë të mbetjeve?	L
Mungesë e buxhetit si zë i veçantë për mbetjet plastike	Mungesa e buxhetit si zë i veçantë për menaxhimin e mbetjeve plastike mund të sjellë pamundësi të zbatimit të legjislacionit.	- Mungesa e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve plastike të prodhuara;	M		M
Nismat edukuese dhe informuese për qytetarët lidhur me mbetjet plastike	MTM dhe NJQV-të mund të mos kenë organizuar mjaftueshëm nisma edukuese dhe informuese për qytetarët lidhur me diferencimin e mbetjeve në tërësi dhe mbetjeve plastike në veçanti.	- Mos njohje nga ana e qytetarëve për rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim si dhe dëmeve që vijnë nga mbetjet plastike;	L	A ka marrë MTM dhe bashkitë nisma për të nxitur aktivitete informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre?	L
Grumbullimi i ndarë i mbetjeve	NJQV-të mund të mos bëjnë grumbullimin e ndarë të mbetjeve sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi.	-MTM nuk ka informacion mbi situatën reale lidhur me mbetjet	L	A janë marrë nisma nga bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan për zbatimin e legjislacionit lidhur me grumbullimin e ndarë të mbetjeve?	L
	Ndarja e mbetjeve në burim nuk realizohet.		L		L

³³ L-risku i lartë, M-risku mesatar, grupi i auditimit ka marrë në konsideratë vetëm nivelin e lartë dhe mesatar të riskut.


³⁴Shkalla e lidhjes së riskut me aktivitetet dhe vështirësitë e subjektit në tejkalimin e riskut. L-e lartë, M-mesatare.

		plastike;			
Të dhënat mbi sasinë e mbetjeve plastike, burimin e krijimit dhe trajtimit të tyre	Të dhënat mbi sasinë e mbetjeve plastike të prodhuara, burimin e krijimit mund të mos jenë të plota dhe të besueshme.	- MTM nuk ka informacion mbi nivelin e zbatueshmërisë së kuadrit ligjor; - Ndikimi i lartë që kanë mbetjet plastike në ngrohjen globale	L	A ka MTM të dhëna lidhur me sasinë, burimin dhe trajtimin e mbetjeve plastike?	L
	Metodologjia për llogaritjen e të dhënave për mbetjet plastike të prodhuara mund të mos jetë e përshtatshme.		L		L
Monitorimi i zbatimit të legjislacionit dhe arritjes së objektivave	MTM nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj mund të mos ketë bërë monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në përputhje me përcaktimet ligjore lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve në tërësi dhe menaxhimin e mbetjeve plastike në veçanti.		L	A janë hartuar raporte monitorimi mbi zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve ku përfshihen dhe mbetjet plastike?	L
	MTM mund të mos ketë grumbulluar informacion lidhur me arritjen e objektivave specifike për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike.		L		L
Perceptimi nga qytetarët për rëndësinë e ndarjes së mbetjeve dhe dëmin që vjen nga mbetjet plastike	Iniciativat e marra nga strukturat përgjegjëse për ndërgjegjësimin e qytetarëve mund të mos kenë dhënë rezultatet e dëshiruara.		L	A kanë informacion qytetarët për ndarjen e mbetjeve dhe dëmin e mbetjeve plastike?	L

3.2 Objektivat e auditimit

Objektivi kryesor i auditimit të performancës me temë “Menaxhimi i Mbetjeve Plastike” është vlerësimi i efektivitetit të procesit të menaxhimit të mbetjeve plastike si dhe pasqyrimi i qartë dhe i plotë të situatës në vendin tonë duke synuar përmirësimin e procesit të menaxhimit të mbetjeve plastike.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Auditimi me temë “Menaxhimi i mbetjeve plastike”, ka mbuluar periudhën 2017-2020 dhe është fokusuar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si ministria përgjegjëse në hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me menaxhimin e mbetjeve plastike si dhe në Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë duke qenë se institucionet e vetëqeverisjes vendore kanë një sërë përgjegjësish lidhur me menaxhimin e mbetjeve plastike. Grupi i auditimit ka konstatuar deri më tani se menaxhimi i mbetjeve plastike në vendin tonë nuk është i ndarë nga procesi i menaxhimit të mbetjeve urbane.

Për të dhënë një vlerësim të efektivitetit të procesit të menaxhimit të mbetjeve plastike grupi i auditimit do të ketë në fokus shqyrtimin dhe analizimin e çështjeve si më poshtë:

- Hartimin e legjislacionit specifik për menaxhimin e mbetjeve plastike dhe nëse ky legjislacion është në harmoni me strategjitë dhe direktivat e BE-së për menaxhimin e mbetjeve plastike;
- Nivelin e zbatimit të objektivave strategjike dhe të legjislacionit që prek indirekt dhe direkt menaxhimin e mbetjeve plastike;
- Përbushjen e detyrave të strukturave përgjegjëse për monitorimin e procesit të menaxhimit të mbetjeve ku mbetjet plastike janë pjesë;
- Procesin e menaxhimit të mbetjeve plastike si pjesë përbërëse e menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel vendor;
- Nismat e marra për informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me mbetjet plastike dhe dëmin e tyre;
- Përfshirjen e grupeve të interesit në hartimin e politikave për menaxhimin e mbetjeve plastike në nivel qendror dhe vendor.

3.5 Kriteret

<i>Pyetja Kryesore</i>	<i>A ka qenë efektiv menaxhimi i mbetjeve plastike nga MTM dhe bashkitë Tiranë, Vlorë, Elbasan për periudhën 2017-2019?</i>		
<i>Pyetjet e nivelit të Parë</i>	<i>Pyetjet e nivelit të Dytë</i>	<i>Kriteret Krahasuese*</i>	<i>Referenca</i>
1.1 A kanë miratuar MTM dhe bashkitë kuadrin rregullator të nevojshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike?	1.1.1 A është i plotë dhe i përditësuar kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike?	<p>KA 1. Azhurnimi dhe zbatimi i plotë i “Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010-2025” dhe “Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010-2025”;</p> <p>KA 2. Ministria harton programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit.</p> <p>KA 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kërkesa për menaxhimin edhe të rrymave të tjera të mbetjeve të ndryshme.</p> <p>KA 4. Çdo qark harton planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve.</p> <p>KA 5. Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve.</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI-II 2015 – 2020 – kapitulli 12.2.2.</p> <p>Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 50 (seksioni 3.1.1.1).</p> <p>Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 14 - pika 1, neni 42, neni 12 – pika 1, neni 12 – pika 2</p>

	1.1.2 A është kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike në harmoni me legjislacionin e BE-së?	KA 6. Qeveria është angazhuar që të gjitha direktivat e BE-së lidhur me mjedisin dhe sektorin e administrimit të mbetjeve, të kthehen në një ligj shqiptar.	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 31.
1.2 A kanë zbatuar MTM dhe bashkitë kuadrin rregullator në fuqi për menaxhimin e mbetjeve plastike?	1.2.1 A janë marrë nisma nga bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan për zbatimin e legjislacionit lidhur me grumbullimin e ndarë të mbetjeve?	KA 7. Bashkitë të organizojnë apo të krijojnë një sistem grumbullimi të veçantë ose ndarje të mbetjeve në rryma të ndryshme. KA 8. Njësitë e qeverisjes vendore grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet, brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastikë dhe qelq. KA 9. Kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ. KA 10. Pas 2 muajsh nga hyrja në fuqi e VKM Nr. 232 ndalohet hedhja në treg apo përdorimi në çdo rast i qeseve të lehta plastike mbajtëse - ndalohet hedhja në treg apo përdorimi në çdo rast i qeseve plastike mbajtëse të pabiodegradueshme.”.	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 53 (seksioni 3.2.1), Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 18, pika 3, neni 21 – pika 12. VKM Nr. 232, datë 26.4.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 177, Datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre” – pika 8
	1.2.2 A ka marrë MTM dhe bashkitë nisma për nxitur aktivitete informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre?	KA 11. Përmirësimi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit - Sisteme të ndërgjegjësimit afatgjatë do të ngrihen nëpërmjet sistemit arsimor dhe integritit të temave mjedisore në programin e shkollave dhe atyre të arsimit të lartë. KA 12. Do të zhvillohen fushata informuese për të lehtësuar një fushatë më të madhe për parandalimin e prodhimit të mbetjeve drejtuar familjeve. KA 13. Edukimi në menaxhimin e mbetjeve - Edukimi mjedisor i publikut do të mbështetet nga programe specifike në bashkëpunim me shoqërinë civile - Fushata për informimin e publikut.	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 37 (seksioni 2.2.3.5), fq 47 (seksioni 2.4.1), faqe 51 (seksioni 3.1.2 dhe 3.1.2.1)
	1.2.3 A kanë informacion qytetarët për ndarjen e mbetjeve dhe dëmin e mbetjeve plastike?	KA 14. Qytetarët duhet të kenë informacion të qartë, të thjeshtë dhe konciz lidhur me produktet plastike dhe dëmet potenciale të plastikës.	European Strategy on Plastic Waste in the Environment Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve fq.9
1.3 A ka monitoruar MTM zbatimin e	1.3.1 A ka MTM të dhëna lidhur me sasinë, burimin dhe trajtimin e mbetjeve	KA 15. Bashkitë e kategorisë së parë, përcaktojnë, brenda datës 31 Dhjetor 2016, masat e përshtatshme për	VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve

<p>legjislaconit për menaxhimin e mbetjeve plastike?</p>	<p>plastike?</p>	<p>grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.</p> <p>KA 16. Njësitë e qeverisjes vendore, brenda 31 dhjetorit 2018, përcaktojnë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.</p> <p>KA 17. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre, këto të dhëna ia dërgojnë këshillit të qarkut përkatës, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën/transportin brenda datës 31 janar, të çdo viti.</p> <p>KA 18. AKM, në bashkëpunim me Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit, organet doganore e tatimore dhe Inspektoratin Qendror Teknik, mbledh dhe administron në mënyrë periodike vjetore informacionin e dërguar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi sasinë e qeseve plastike mbajtëse, si dhe sasinë e tyre të përdorur në industrinë ricikluese.”.</p> <p>KA 19. DPD raporton, brenda datës 28 shkurt të çdo viti, në AKM, për: - importet dhe eksportet e mallrave ambalazh dhe të mallrave të ambalazhuara; - sasinë e ambalazheve të prodhuara dhe të hedhura në treg”.</p>	<p>në Burim“, kreu IV- pika 1, pika 2.</p> <p>VKM nr. 687, datë 29.07.2015, pika 4.</p> <p>VKM Nr. 232, datë 26.4.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 177, Datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre” – pika 5, pika 6.</p>
	<p>1.3.2 A janë hartuar raporte monitorimi mbi zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve ku përfshihen³. dhe mbetjet plastike?</p>	<p>KA 20. MTM publikon buletine të rregullta mbi zbatimin e strategjisë dhe buletine të rregullta të gjendjes së mjedisit, duke përfshirë edhe një raport vjetor, të gjithë aktorëve të administrimit të mbetjeve.</p> <p>KA 21. Ministri raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në formatin e përcaktuar nga ministri.</p> <p>KA 22. Çdo fund viti, Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve paraqet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në shkallë vendi.</p> <p>KA 23. MTM përgatit çdo tre vjet një raport për zbatimin e ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.</p> <p>KA 24. Ministria, mbështetur në të dhënat e AKM, harton raportin për</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 66 (seksioni 5.1.3.3)</p> <p>Ligji Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 11-pika 6, neni 15 – pika 2, neni 66 – pika 1.</p> <p>VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim“, kreu VIII - pika 3, kreu IX – pika 3.</p> <p>VKM Nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e</p>

		<p>zbatimin e VKM-së 418, si pjesë integrale të raportit për zbatimin e ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, të parashikuar në pikën 1, të nenit 66, brenda 30 Tetorit 2017, dhe më pas çdo tre vjet.</p> <p>KA 25. Ministria është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të VKM nr. 418.</p>	<p>të Funksionimit të Komitetit të Menaxhimit Të Integruar të Mbetjeve”, pika 8</p>
--	--	---	---

3.6 Qasja e auditimit dhe metodologjia e auditimit

Në këtë auditim grupi i auditimit është fokusuar në auditimin e efektivitetit të procesit të menaxhimit të mbetjeve plastike duke parë aspekte të hartimit, përditësimit, zbatimit dhe monitorimit të kuadrit ligjor si dhe efektivitetin në edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me ndarjen e mbetjeve dhe pasojat e mbetjeve plastike. Si rezultat qasja që do të përdoret do të jetë një përzierje e qasjes sasiore dhe cilësore e orientuar drejt rezultateve.

Metodologjia e auditimit

Për t’ju dhënë përgjigje pyetjeve të auditimit grupi i auditimit ka përdoruar metodologjinë si më poshtë:

- Intervista me nëpunësit përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në menaxhimin e mbetjeve plastike;
- Shqyrtimi dhe analizimi i dokumenteve, rregulloreve, manualeve, statistikave të grumbulluara;
- Shqyrtim i legjislacionit specifik, rregulloreve, raporteve dhe informacionit mbi mbetjet në tërësi ku përfshihen dhe mbetjet plastike;
- Vizita informuese dhe vizita audituese në terren për të parë nga afër situatën reale dhe për të kuptuar procesin aktual të menaxhimit të mbetjeve;
- Pyetësorë me qytetarët dhe palët e përfshira lidhur me perceptimin dhe përfshirjen e tyre dhe analizimin e përgjigjeve;

3.7 Matrica e auditimit

<i>Pyetja Kryesore</i>	<i>A ka qenë efektiv menaxhimi i mbetjeve plastike nga MTM dhe bashkitë Tiranë, Vlorë, Elbasan për periudhën 2017-2019?</i>						
<i>Pyetjet e nivelit të Parë</i>	<i>Pyetjet e nivelit të Dytë</i>	<i>Kriteret Krahasuese*</i>	<i>Referenca</i>	<i>Dokumentacioni që do shqyrtohet /Evidenca</i>	<i>Burimi i evidencave</i>	<i>Mënyra e grumbullimit të të dhënave</i>	<i>Puna specifike që do të kryhet</i>
1.1 A kanë miratuar MTM dhe bashkitë kuadrin rregullator të nevojshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike?	1.1.1 A është i plotë dhe i përditësuar kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike? E. K.	<p>KA 1. Azhurnimi dhe zbatimi i plotë i “Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010-2025” dhe “Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010-2025”;</p> <p>KA 2. Ministria harton programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit.</p> <p>KA 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kërkesa për menaxhimin edhe të rrymave të tjera të mbetjeve të ndryshme.</p> <p>KA 4. Çdo qark harton planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve.</p> <p>KA 5. Çdo njësi e qeverisjes vendore apo</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI-II 2015 – 2020 – kapitulli 12.2.2.</p> <p>Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 50 (seksioni 3.1.1.1).</p> <p>Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 14 - pika 1, neni 42, neni 12 – pika 1, neni 12 – pika 2</p>	<p>Raporte të monitorimit;</p> <p>Minuta takimi;</p> <p>Përgjigje të pyetësorëve;</p> <p>Përgjigje të intervistave;</p> <p>Vëzhgime të grupit të auditimit; Të dhëna të raportuara;</p> <p>Analiza të grupit të auditimit.</p>	<p>Nga MTM AKM Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan; raporte – analiza vjetore – përgjigjet e pyetësorëve – përgjigjet e intervistave – vëzhgime në terren të grupit të auditimit – të dhënat e raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në AKM</p>	<p>Intervista, Pyetësorë, Kërkime në internet,</p> <p>Kërkohen nga subjekti dokumente specifike</p>	<p>Shqyrtim dhe analizim cilësor i dokumenteve; analizim i përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave; analizim të dhënash; vëzhgime të grupit të auditimit</p>

		grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve.					
	1.1.2 A është kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike në harmoni me legjislacionin e BE-së? E. K.	KA 6. Qeveria është angazhuar që të gjitha direktivat e BE-së lidhur me mjedisin dhe sektorin e administrimit të mbetjeve, të kthehen në një ligj shqiptar.	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 31.			Intervista, Pyetësorë, Kërkime në internet, Kërkohen nga subjekti dokumente specifike	Shqyrtim dhe analizim cilësor i dokumenteve; analizim i përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave; analizim të dhënash; vëzhgime të grupit të auditimit
1.2 A kanë zbatuar MTM dhe bashkitë kuadrin rregullator në fuqi për menaxhimin e mbetjeve plastike?	1.2.1 A janë marrë nisma nga bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan për zbatimin e legjislacionit lidhur me grumbullimin e ndarë të mbetjeve? A. G.	KA 7. Bashkitë të organizojnë apo të krijojnë një sistem grumbullimi të veçantë ose ndarje të mbetjeve në rryma të ndryshme. KA 8. Njësitë e qeverisjes vendore grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet, brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastikë dhe qelq. KA 9. Kryetarët e njëjive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 53 (seksioni 3.2.1), Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 18, pika 3, neni 21 – pika 12. VKM Nr. 232, datë 26.4.2018 “Për disa	Raporte të monitorimit; Minuta takimi; Përgjigje të pyetësorëve; Përgjigje të intervistave; Vëzhgime të grupit të auditimit; Të dhëna të raportuara; Analiza të grupit të auditimit.	Raporte – analiza vjetore – përgjigjet e pyetësorëve – përgjigjet e intervistave – vëzhgime në terren të grupit të auditimit – të dhënat e raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në AKM	Intervista, Pyetësorë, Kërkime në internet, Kërkohen nga subjekti dokumente specifike	Shqyrtim dhe analizim cilësor i dokumenteve; analizim i përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave; analizim të dhënash; vëzhgime të grupit të auditimit

		<p>që krijohen brenda territorit të tyre administrativ.</p> <p>KA 10. Pas 2 muajsh nga hyrja në fuqi e VKM Nr. 232 ndalohet hedhja në treg apo përdorimi në çdo rast i qeseve të lehta plastike mbajtëse - ndalohet hedhja në treg apo përdorimi në çdo rast i qeseve plastike mbajtëse të pabiodegradueshme.”.</p>	<p>ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 177, Datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre” – pika 8</p>				
<p>1.2.2 A ka marrë MTM dhe bashkitë nisma për nxitur aktivitete informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre?</p> <p>A. G.</p>	<p>KA 11. Përmirësimi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit - Sisteme të ndërgjegjësimit afatgjatë do të ngrihen nëpërmjet sistemit arsimor dhe integritimit të temave mjedisore në programin e shkollave dhe atyre të arsimit të lartë.</p> <p>KA 12. Do të zhvillohen fushata informuese për të lehtësuar një fushatë më të madhe për parandalimin e prodhimit të mbetjeve drejtuar familjeve.</p> <p>KA 13. Edukimi në menaxhimin e mbetjeve - Edukimi mjedisor i publikut do të mbështetet nga programe specifike në bashkëpunim me shoqërinë civile - Fushata</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 37 (seksioni 2.2.3.5), fq 47 (seksioni 2.4.1), faqe 51 (seksioni 3.1.2 dhe 3.1.2.1)</p>	<p>Raporte të monitorimit;</p> <p>Minuta takimi;</p> <p>Përgjigje të pyetësorëve;</p> <p>Përgjigje të intervistave;</p> <p>Vëzhgime të grupit të auditimit; Të dhëna të raportuara;</p> <p>Analiza të grupit të auditimit.</p>	<p>Raporte – analiza vjetore – përgjigjet e pyetësorëve – përgjigjet e intervistave – vëzhgime në terren të grupit të auditimit – të dhënat e raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në AKM</p>	<p>Intervista, Pyetësorë, Kërkime në internet,</p> <p>Kërkohen nga subjekti dokumente specifike</p>	<p>Shqyrtim dhe analizim cilësor i dokumenteve; analizim i përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave; analizim të dhënash; vëzhgime të grupit të auditimit</p>	

		për informimin e publikut.					
	1.2.3 A kanë informacion qytetarët për ndarjen e mbetje dhe dëmin e mbetjeve plastike? A. G.	Qytetarët duhet të kenë informacion të qartë, të thjeshtë dhe konçiz lidhur me produktet plastike dhe dëmet potenciale të plastikës.	European Strategy on Plastic Waste in the Environment	Raporte të monitorimit; Minuta takimi; Përgjigje të pyetësorëve; Përgjigje të intervistave; Vëzhgime të grupit të auditimit; Të dhëna të raportuara; Analiza të grupit të auditimit.	Raporte – analiza vjetore – përgjigjet e pyetësorëve – përgjigjet e intervistave – vëzhgime në terren të grupit të auditimit – të dhënat e raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në AKM	Intervista, Pyetësorë, Kërkime në internet, Kërkohen nga subjekti dokumente specifike	Shqyrtim dhe analizim cilësor i dokumenteve; analizim i përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave; analizim të dhënash; vëzhgime të grupit të auditimit
1.3 A ka monitoruar MTM zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve plastike?	1.3.1 A ka MTM të dhëna lidhur me sasinë, burimin dhe trajtimin e mbetjeve plastike? S. J.	KA 14. Bashkitë e kategorisë së parë, përcaktojnë, brenda datës 31 Dhjetor 2016, masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. KA 15. Njësitë e qeverisjes vendore, brenda 31 dhjetorit 2018, përcaktojnë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. KA 16. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të plotësojnë formatin e raportimit të	VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim“, kreu IV- pika 1, pika 2. VKM nr. 687, datë 29.07.2015, pika 4. VKM Nr. 232, datë 26.4.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 177, Datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”– pika 5, pika 6.	Raporte të monitorimit; Minuta takimi; Përgjigje të pyetësorëve; Përgjigje të intervistave; Vëzhgime të grupit të auditimit; Të dhëna të raportuara; Analiza të grupit të auditimit.	Raporte – analiza vjetore – përgjigjet e pyetësorëve – përgjigjet e intervistave – vëzhgime në terren të grupit të auditimit – të dhënat e raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në AKM	Intervista, Pyetësorë, Kërkime në internet, Kërkohen nga subjekti dokumente specifike	Shqyrtim dhe analizim cilësor i dokumenteve; analizim i përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave; analizim të dhënash; vëzhgime të grupit të auditimit

		<p>statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre, këto të dhëna ia dërgojnë këshillit të qarkut përkatës, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën/transportin brenda datës 31 janar, të çdo viti.</p> <p>KA 17. AKM, në bashkëpunim me Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit, organet doganore e tatimore dhe Inspektoratin Qendror Teknik, mbledh dhe administron në mënyrë periodike vjetore informacionin e dërguar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi sasinë e qeseve plastike mbajtëse, si dhe sasinë e tyre të përdorur në industrinë ricikluese.”.</p> <p>KA 18. DPD raporton, brenda datës 28 shkurt të çdo viti, në AKM, për: - importet dhe eksportet e mallrave ambalazh dhe të mallrave të ambalazhuara; - sasinë e ambalazheve të prodhuara dhe të hedhura në treg”.</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--

	<p>1.3.2 A janë hartuar raporte monitorimi mbi zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve ku përfshihen dhe mbetjet plastike?</p> <p>S. J.</p>	<p>KA 19. MTM publikon buletine të rregullta mbi zbatimin e strategjisë dhe buletine të rregullta të gjendjes së mjedisit, duke përfshirë edhe një raport vjetor, të gjithë aktorëve të administrimit të mbetjeve.</p> <p>KA 20. Ministri raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në formatin e përcaktuar nga ministri.</p> <p>KA 21. Çdo fund viti, Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve paraqet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në shkallë vendi.</p> <p>KA 22. MTM përgatit çdo tre vjet një raport për zbatimin e ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.</p> <p>KA 23. Ministria, mbështetur në të dhënat e AKM, harton raportin për zbatimin e VKM-së 418,</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Planit Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr.175, datë 19.1.2011 fq. 66 (seksioni 5.1.3.3)</p> <p>Ligji Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 11- pika 6, neni 15 – pika 2, neni 66 – pika 1.</p> <p>VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim“, kreu VIII - pika 3, kreu IX – pika 3.</p> <p>VKM Nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Komitetit të Menaxhimit Të Integruar të Mbetjeve”, pika 8</p>	<p>Raporte të monitorimit;</p> <p>Minuta takimi;</p> <p>Përgjigje të pyetësorëve;</p> <p>Përgjigje të intervistave;</p> <p>Vëzhgime të grupit të auditimit; Të dhëna të raportuara;</p> <p>Analiza të grupit të auditimit.</p>	<p>Raporte – analiza vjetore – përgjigjet e pyetësorëve – përgjigjet e intervistave – vëzhgime në terren të grupit të auditimit – të dhënat e raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në AKM</p>	<p>Intervista, Pyetësorë, Kërkime në internet,</p> <p>Kërkohen nga subjekti dokumente specifike</p>	<p>Shqyrtim dhe analizim cilësor i dokumenteve; analizim i përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave; analizim të dhënash; vëzhgime të grupit të auditimit</p>
--	--	--	---	--	--	---	--

		<p>si pjesë integrale të raportit për zbatimin e ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, të parashikuar në pikën 1, të nenit 66, brenda 30 Tetorit 2017, dhe më pas çdo tre vjet.</p> <p>KA 24. Ministria është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të VKM nr. 418.</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--

4. SH TJELLIMI I PYETJEVE DHE NËN PYETJEVE

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, grupiauditimit i ka dhënë përgjigje pyetjes kryesore:- “A ka qenë efektiv menaxhimi i mbetjeve plastike nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkitë Tiranë, Vlorë, Elbasan për periudhën 2017-2020?” -**duke arritur në këtë mesazh:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë qenë efektive sa i përket menaxhimit të mbetjeve plastike për periudhën 2017-2020. Mangësi të theksuara janë vërejtur në hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor e rregullator të nevojshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike. MTM nuk ka hartuar Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve dhe nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, ndërsa Bashkia Tiranë dhe Vlorë nuk kanë hartuar dhe miratuar Planet Vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk kanë krijuar infrastrukturën e nevojshme për të bërë të mundur grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim dhe objektivi kryesor për përdorimin dhe riciklimin e plastikës me 22.5 % kundrejt volumit total që krijohet në këto bashki, nuk është arritur dhe nuk do të arrihet për aq kohë sa infrastruktura do të jetë kjo që është.

Aktivitetet informuese dhe edukuese që Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë do të duhej të arrinin nëpërmjet kompanive private që kryejnë shërbimin e pastrimit të qytetit dhe që kanë detyrimin kontraktual për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve nuk janë arritur. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk kanë të dhëna të plota dhe të sakta në nivel kombëtar, mbi sasinë e mbetjeve plastike që gjenerohen dhe riciklohen në Shqipëri. Të dhënat mbi sasinë e mbetjeve plastike të gjeneruara dhe të menaxhuara do të vazhdojnë të jenë problem deri në momentin që NJQV të arrijnë të sigurojnë ndarjen e mbetjeve në burim (duke qenë se ndarja në burim nuk bëhet në asnjë prej bashkive subjekt auditimi), grumbullimin e diferencuar dhe peshimin e sasisë së mbetjeve sipas rrymave në momentin dërgimit të tyre në landfill, incenerator.

4.1 A kanë miratuar MTM dhe bashkitë kuadrin rregullator të nevojshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike?

Miratimin e kuadrit rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike nga MTM dhe Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan grupi i auditimit e analizoi në dy aspekte që i klasifikoi si më të rëndësishme:

- Vlerësimin nëse kuadri rregullator është i plotë dhe i përditësuar;
- Vlerësimin nëse kuadri rregullator është në harmoni me legjislacionin e BE-së.

4.1.1 A është i plotë dhe i përditësuar kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike?

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri.

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve (SKMM) miratuar me VKM nr. 175, datë 19.07.2011, futi për herë të parë në legjislacionin shqiptar termin “menaxhim i mbetjeve”, pasi deri në këtë kohë, procesi quhej “administrim i mbetjeve” dhe konsistonte në largimin e mbetjeve dhe pastrimin e territorit prej tyre. Para miratimit të kësaj strategjie administrimi i mbetjeve në Shqipëri kryhej sipas Ligjit nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin e mbetjeve të ngurta”.

SKMM dhe Plani Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve janë hartuar në një dokument të vetëm. Në këtë dokument paraqitet situata e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri në vitin 2011, parashikohen nevojat për përmirësimin e legjislacionit dhe përafrimin e tij me

direktivave të BE-së, si dhe theksohet rëndësia e përmbushjes së objektivave për të arritur një menaxhim të integruar të mbetjeve efektiv. SKMM bazohet në katër shtyllat themelore politike të politikës kombëtare mbi mbetjet, si: planifikimi, edukimi, burimet dhe legjislativi.³⁵

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” kërkon zbatimin e parimeve të ligjit kuadër për mjedisin dhe parimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të cilat e vendosin nivelin e menaxhimit të mbetjeve në një nivel më të lartë mbrojtjeje sesa kanë bërë ligjet e mëparshme. Ky ligj ka për qëllim³⁶:

- Të mbrojtë mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- Të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve, nëpërmjet parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve, nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre si dhe pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” në nenin 6 të tij dhe në linjë me SKMM-në, përcakton se mbetjet menaxhohen sipas hierarkisë së mbetjeve e cila është 1.Parandalimi; 2.Ripërdorimi; 3.Riciklimi; 4.Rikuperimi; dhe 5.Asgjësimi, hierarki e cila është e përcaktuar edhe në Direktivën 2008/98/KE “Për mbetjet”.

Këshilli i Ministrave në zbatim të Ligjit 10431/2011, në bazë të dispozitës kalimtare neni 71-71, ka miratuar një pjesë të akteve nënligjore (që përfshijnë dhe mbetjet plastike) sipas përcaktimeve në këtë ligj, të cilat janë:

- VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, ndryshuar me Vendim nr. 232, datë 26.4.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të këshillit të ministrave, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.
- VKM nr. 967, datë 25.10.2013, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve”.
- VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.
- VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
- VKM nr. 579, datë 03.09.2014 “Për një shtesë në VKM nr. 99, datë 18.2.2005, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- VKM nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte”.
- VKM nr. 687, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.
- Vendim nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”
- Vendim nr. 389, datë 27.6.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për landfillet e mbetjeve”.

Me dispozite kalimtare, neni 72, është lejuar vazhdimi i disa akteve nënligjore të cilat mbeten në fuqi deri në shfuqizimin të tyre me akt të veçantë, ku përmendim:

- VKM nr. 99, datë 18.02.2005, “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve”, e cila në vijim është ndryshuar (shtuar) me VKM nr. 579, datë 03.09.2014, të sipërcituar.

³⁵ VKM nr. 175, datë 19.07.2011 “Strategjia dhe Plani Kombëtar I MIM”, faqe 31

³⁶Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 1.

- VKM nr. 825, datë 13.10.2010, “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve plastike si pjesë e menaxhimit të integruar të mbetjeve

Nga shqyrtimet e legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve cituar më sipër, disa akte nënligjore mund të klasifikohen të hartuara posaçërisht për mbetjet plastike ose akte ligjore në të cilat mbetjet plastike janë pjesë përbërëse e përcaktimeve për menaxhimin e rrymave të mbetjeve. Përkatësisht, baza ligjore për menaxhimin e mbetjeve plastike është si më poshtë:

- VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, e ndryshuar me VKM nr. 232, datë 26.04.2018, për ndryshimin e VKM-së 177 e njohur ndryshe si VKM për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike;
- VKM nr. 418, datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”. Akti nënligjor dalë dalë në mbeshtetje të nenit 18 të ligjit kuadër, për ripërdorimin /riciklimin, ka për qëllim përcaktimin e afateve dhe masave për grumbullimin e diferencuar me objekt realizimin e grumbullimit të diferencuar për 4 rryma mbetjesh : a- Leter/karton; b-Metal; c- Plastikë dhe ç-Qelq




Figura 7: Legjislacioni i përgjithshëm për MIM përkundëjt legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve plastike

Siç mund të vërehet nga një vështrim i thjeshtë i figurës 7, si dhe referuar trajtimit më sipër, legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve plastike kufizohet vetëm në dy akte nënligjore, të cilat do të trajtohen më gjerësisht në vijim.

Përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit: Referuar Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masat e nevojshme që çdo person juridik a fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte (prodhuesi i produktit) mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit. Me përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit synohet të rritet parandalimi, ripërdorimi, riciklimi dhe rikuperime të tjera të mbetjeve. Në masat që duhen marrë përfshihet pranimi i produkteve të kthyera dhe të mbetjeve që teprojnë pas përdorimit të tyre, si dhe menaxhimi i ardhshëm i mbetjeve dhe përgjegjësitë financiare për veprimtari të tilla. Në masa të tilla përfshihet edhe detyrimi për të ofruar publikisht informacionin e disponueshëm për masën, në të cilën produkti është i ripërdorshëm dhe i riciklueshëm. Në përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit përfshihen edhe masa, që nxisin projektimin e produkteve, në mënyrë që të pakësohen ndikimet e tyre në mjedis dhe krijimi i mbetjeve gjatë prodhimit dhe përdorimit të produkteve, dhe që sigurojnë kryerjen e

rikuperimit dhe të asgjësimit të produkteve të shndërruara në mbetje, në përputhje me këtë ligj. Në këtë mënyrë synohet të nxitet zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i mallrave që janë të përshtatshme për shumë përdorime, që kanë jetë të gjatë dhe për të cilat, kur shndërrohen në mbetje, rikuperimi dhe asgjësimi kryhen në mënyrë të sigurt dhe pa ndikim në mjedis. Gjatë planifikimit të këtyre masave merren plotësisht në konsideratë bëshmëria teknike, leverdia ekonomike dhe ndikimet e përgjithshme mbi shoqërinë, mjedisin dhe shëndetin e njeriut, duke respektuar legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve, kërkesat thelbësore për produktet jo ushqimore dhe vlerësimin e konformitetit.³⁷

Aktorët përgjegjës për hartimin e politikave për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë mbetjet plastike si një nga rrymat e mbetjeve, janë si më poshtë.

1. **MTM**, edhe pas ristrukturimit me VKM 509/2017 ka përgjegjësinë e hartimit dhe miratimit të kuadrit e përgjithshëm rregullator dhe të politikave për të gjitha llojet e mbetjeve si dhe mbikëqyr tërësisht administrimin e tyre. MTM është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe të Planit të Veprimit për menaxhimin e mbetjeve në vend. Së bashku me institucione e varësisë ministria ka përgjegjësinë e përgjithshme për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. MTM ka në përgjegjësi:³⁸

- Hartimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit;
- Hartimin e programeve të parandalimit për krijimin e mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit;
- Në bashkëpunim me autoritetet përkatëse nxit ripërdorimin e produkteve dhe përgatitjen e veprimtarive të ripërdorimit, në veçanti, duke nxitur ngritjen dhe mbështetjen e rrjeteve të ripërdorimit, përdorimin e instrumenteve ekonomike, zbatimin e kriterëve të prokurimit, arritjen e objektivave sasiore ose marrjen e masave të tjera.

2. **Qarqet** hartojnë planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që kanë nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe me kërkesat e ligjit.³⁹

3. **Njësitë e Qeverisjes Vendore** (secila më vete apo në grup) hartojnë planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që kanë nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Çdo NJQV (apo grup njësisish të qeverisjes vendore) përcakton rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve, që gjenerohen në territorin e vet, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve. Këto rregullore miratohen nga Këshilli i Qarkut.⁴⁰

- Bashkitë e kategorisë së parë, në përputhje me brenda datës 31 Dhjetor 2016, marrin masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku një një ndër rrymat është dhe plastika.
- Njësitë e qeverisjes vendore, (përveç atyre të nivelit të parë të sipërpërmendura) brenda 31 dhjetorit 2018, marrin masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku një një ndër rrymat është dhe plastika.⁴¹

³⁷ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", Neni 16.

³⁸ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", nenet 10, 14, 18.

³⁹ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 12, pika 1.

⁴⁰ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 12, pika 2 dhe 3.

⁴¹ VKM nr. 418, datë 25.06.2014, "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", Kreu IV.

Planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, duhet të hartohen në përputhje me Planin Kombëtar dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, dhe në to duhet të parashikohen masa e metoda për arritjen e objektivave brenda afateve të vendosura.⁴²

Sistemi menaxhimit të integruar të mbetjeve duhet drejtuar përmes katër niveleve të instrumente planifikues⁴³:

- Niveli I Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Veprimit i cili është niveli më i lartë i planifikimit, dhe shërben si gur themeli për ndërtimin e strategjive dhe planet e menaxhimit të mbetjeve.
- Niveli II Plani Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, që orientohet drejt identifikimit dhe përcaktimit të metodologjisë, përcaktimi kostove dhe tarifave, një sistem objektiv të prioriteteve të investimeve të menaxhimit të mbetjeve
- Niveli III Planet Rajonal/ Zonal: Këto plane duhet të mbështeten në studime fizibilitetit, të cilat hartohen nga ministria përgjegjëse, duke ruajtur parimet dhe standardet evropiane për mbrojtjen e mjedisit.
- Niveli IV: Planet Vendore: Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Në procesin e planifikimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, vihen re një sërë mangësish në hartimin dhe miratimin e legjislacionit, si më poshtë vijon:

- **Niveli më i lartë** në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve është Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035 i miratuar me VKM nr. 418 datë 27.05.2020 i cili është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.⁴⁴ Ky dokument ka zëvendësuar Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve i cili ka qenë i miratuar me anë të VKM nr. 175 datë 19.01.2011.

- **Në nivelin e dytë:** Plani Kombëtar Sektorial për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta, kërkon zbatimin e sistemeve në nivelin e Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve. Zona e Mbetjeve është njësi bazë për planifikimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Çdo zonë duhet të këtë kufijtë e saj që përcaktohen paraprakisht në Master Plan për menaxhimin e Integruar të mbetjeve, i cili deri në vitin 2019 nuk ka ekzistuar. Strategjia e re VKM 418/2020 përcakton si objektiv strategjik, hartimin e një Master Plani për rryma të veçanta mbetjesh, dhe synon të realizohet në vitin 2030. Zona e Mbetjeve janë subjekt dhe përcaktohen në Master Plan, bazuar mbi përfundimet e një Studimi Fizibiliteti. Zona e Mbetjeve e përcaktuar nga Studimi i Fizibilitetit miratohet nga këshillat bashkiake, ligjërohen nga Këshilli i Ministrave pasi ka janë pranuar nga ministritë përgjegjëse për mjedisin dhe infrastrukturën.

Në Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, nën 14 pika 1 dhe 2, përcaktohet se MTM duhet të hartojë programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit.

Në nivel vendor, çdo Njësi e Vetqeverisjes Vendore ka detyrim të hartojë Planin Vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Planet vendore hartohen mbi hierarkinë e mbetjeve dhe parimet e Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

⁴² VKM nr. 418, datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V.

⁴³ VKM 418 datë 27.05.2020, Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar për MIM, 2020-2021,

⁴⁴ Fig: Buxheti i MTM dhe Programi “Mbrojtja e Mjedisit 2017-2020”

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e nivelit të NJQV-ve. Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e NJQV si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre. Në mënyrë të veçantë, "grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake" është përcaktuar si një funksion i bashkive Përgjegjësia e bashkive dhe këshillat e qarqeve, lidhen kryesisht me planifikimin, monitorimin dhe raportimin, por jo me menaxhimin, përcaktohen në Ligjin 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe nga disa akte nënligjore të nxjerra nga ligji si lartpërmendur më sipër.

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve i parashikuar në legjislacion

Sipas legjislacionit shqiptar, duke e nisur me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve, të miratuar me VKM nr. 175, datë 19.01.2011, Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe më tej me VKM nr. 418, datë 25.06.2014, "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", bashkitë ngarkohen me detyrimin që deri në 31 dhjetor 2018, të vendosin një sistem efektiv për ndarjen në burim dhe grumbullimin e diferencuar të paktën 4 rrymave⁴⁵. Për të realizuar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim vendi ynë duhet të ngrëjë infrastrukturë.

Në SKMM është parashikuar që deri në vitin 2020 të ketë një rritje të sasisë së mbetjeve që shkon për ripërdorim dhe riciklim minimumi në 50% të peshës së përgjithshme të mbetjeve të gjeneruara në vitin 2014. Në mënyrë të qartë ndarja e diferencuar e mbetjeve është përcaktuar pikërisht në VKM nr. 418/2014, e cila ka si objekt realizimin e grumbullimit të diferencuar për rrymat e mbetjeve: letër/karton; metal; plastikë; qelq, me qëllim optimizimin e grumbullimit të tyre, sigurimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim, promovimin e ripërdorimit të produkteve, përgatitjen e veprimtarive të ripërdorimit dhe përmirësimin e cilësisë së riciklimit të mbetjeve.⁴⁶ Në VKM 418/2014 objektivat specifike, që duhet të arrihen nga njësitë e qeverisjes vendore synohet riciklim 22.5% për plastikën e cila nuk është arritur nga NJQV .

Problemet grumbullimin e diferencuar në burim, nuk qëndrojnë në mungesën e legjislacionit, por në shkallën e zbatimit të tyre, si mungesa e planeve të qëndrueshme institucionale dhe operacionale, pamjaftueshmërinë e faturës financiare dhe mos ndarje e qartë të përgjegjëseve ndërmjet institucioneve përgjegjëse qendrore dhe vendore.

Observacioni i subjektit: Minsitria e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën prot. nr. 4556/1, datë 06.08.2021, protokolluar në KLSH me nr. 202/9, datë 09.08.2021, sugjeron zgjatjen e periudhës së zbatimit të rekomandimeve nga dhjetor 2021 të bëhet Qershor 2022, me arsyetimin e periudhës tranzitore deri në formimin e qeverisë së re.

Qëndrimi auditues: Në cilësinë e përgjegjësisë së politikëbërjes në procesin e menaxhimit të mbetjeve në tërësi dhe mbetjeve plastike në veçanti, sugjerimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për shtyrjen e zbatimit të rekomandimeve deri në Qershor 2022, u pranua nga grupi i auditimit me arsyetimin se subjekti duhet të ketë në dispozicion kohë të mjaftueshme për të mundësuar zbatimin e rekomandimeve, kur kjo kohë kërkohet prej tij.

Gjetje

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve, në mos përputhje me nenin 14 të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

⁴⁵ VKM nr. 418, datë 25.06.2014, "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të ngurta

⁴⁶ VKM nr. 418, datë 25.06.2014, "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", Paragrafi I dhe II

2. Bashkitë Tiranë dhe Vlorë nuk kanë hartuar dhe miratuar Planet Vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që kanë nën juridiksion në shkëlqje të nenit 12 të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
3. Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar dhe nuk ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave masat e nevojshme që çdo person juridik ose fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 16 pika 1.

Konkluzione

1. Mungesa e Programeve të parandalimit të krijimit të mbetjeve nga ana e MTM ka cënuar zbatimin e Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" në disa elementë. Së pari, këto Programe duhet të ishin pjesë e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve i cili është miratuar me anë të VKM nr. 418 datë 27.05.2020. Gjithashtu, këtë Planet Vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe të hartohen në përputhje me këtë Programe. Afati për hartimin e Programeve të para për parandalimin e mbetjeve bazuar në Ligjin nr. 10463, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 14 pika 2 ka qenë data 1 janar 2017. MTM me mos hartimin e këtyre Programeve ka ndikuar dhe ka sjellë pasoja negative edhe në Bashkitë në të gjithë vendin.
2. Mungesa e Planeve Vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve (e cila ka ardhur edhe për mungesë të Planeve Rajonale) nga ana e Bashkive Tiranë dhe Vlorë sjell mangësi të theksuara në menaxhimin e mbetjeve në tërësi por dhe atyre plastike në veçanti. Plani Vendor i menaxhimit të mbetjeve është dokumenti kryesor në nivel vendor dhe bazuar në të duhet më tej hartohen edhe rregullore për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve⁴⁷.
3. Mungesa e miratimit me VKM të masave të nevojshme mbi të cilat çdo person juridik/fizik duhet të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit ka ndikuar në mos arritjen e objektivave të parandalimit, ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimeve të tjera të mbetjeve të përcaktuara këto në Ligjin nr. 10463, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 14 pika 2. Gjithashtu, kjo mungesë ka sjellë edhe mos përcaktime të qarta të pranimit të produkteve të kthyera dhe të mbetjeve që teprojnë pas përdorimit të tyre, si dhe menaxhimit të ardhshëm i mbetjeve dhe përgjegjësitë financiare për veprimtari të tilla.

Rekomandime

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve sipas rrymave, ku parandalimi i krijimit të mbetjeve plastike të jetë një kapitull i veçantë. Hartimi i programeve të parandalimit të realizohet duke i kushtuar rëndësinë që ato kanë në zbatimin e piramidës së menaxhimit të mbetjeve.

Qershor 2022

2. Bashkitë Tiranë dhe Vlorë të marrin masat e nevojshme dhe të iniciojnë procedurën për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e Planeve Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Dhjetor 2021

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave masat e nevojshme që çdo person juridik ose fizik, i cili zhvillon, prodhon,

⁴⁷ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 12 pika 3.

përpunon, trajton, shet ose importon produkte mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.

Qershor 2022

4.1.2 A është kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike në harmoni me legjislacionin e BE-së?

Përafrimi i legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve me legjislacionin e BE-së është një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve. Direktiva e BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet” përcakton kornizën legjislative për menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve. Ajo përcakton konceptet kryesore të mbetjeve, dhe vendos kërkesat thelbësore për menaxhimin e tyre. Ajo përcakton parimet kryesore si për shembull detyrimet për t’i menaxhuar mbetjet duke mos patur ndikim negativ në mjedis dhe shëndetin njerëzor, inkurajon aplikimin e hierarkisë së mbetjeve dhe nxit parimin “ndotësi – paguan”. Neni 30 i kësaj Direktive përcakton se vlerësimi dhe rishikimi i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Programit të Parandalimit të krijimit të mbetjeve duhet bërë të paktën çdo 6 vjet.

Në direktivën e BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet” kërkohet implementimi i programeve të parandalimit të mbetjeve dhe deri në vitin 2011 të përgatitet një raport mbi evoluimin e gjenerimit të mbetjeve dhe qëllimin e parandalimit të mbetjeve duke përfshirë këtu dhe formulimin e një politike për krijimin e produkteve me dizajn ekologjik. Po brenda vitit 2011 kërkohet përgatitja e një plan veprimi për të rritur impaktin e parandalimit të mbetjeve dhe rrjedhimisht uljen e përdorimit të burimeve dhe materialeve që mund të evitohen nëpërmjet parandalimit. Në fund të vitit 2014 kërkohet dyfishimi i objektivave sa i takon parandalimit të mbetjeve deri në vitin 2020⁴⁸. Në Ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 14 citohet se: *“Ministria e Turizmit dhe Mjedisit harton programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe në mënyrë të veçantë, me hierarkinë e menaxhimit të integruar të mbetjeve”*. Afati për hartimin e programeve të para për parandalimin e krijimit të mbetjeve është jo më vonë se data 1 janar 2017.⁴⁹ Nga analizat e grupit të auditimit rezulton që këto detyrime ligjore të mos jenë përmbushur nga ana e MTM-së. Afati i përcaktuar për hartimin e Programeve të Parandalimit ka tre vite që ka përfunduar dhe nuk rezulton që nga ana e MTM-së të jetë bërë ndonjë përpjekje për të zbatuar detyrimet e nenit 14 të Ligjit për MIM. Në rastin e VKM-së për ndarjen në burim të mbetjeve (të sipërcituar) janë vendosur afate për fillimin e procesit të ndarjes së mbetjeve në burim nga bashkitë, afate të cilat nuk janë realizuar.

Legjislacioni i BE-së për mbetjet plastike, ndër të tjera, është i plotësuar me:

- Raportin paraprak (Green Paper) i Komisionit Europian “Mbi strategjinë Europiane për mbetjet plastike në mjedis”, datë 07.03.2013.⁵⁰
- Strategjinë Europiane për Plastikën në Ekonominë Qarkulluese datë 16.01.2018.⁵¹
- Direktivën EU/2019 e datës 05.06.2019 “Mbi reduktimin e ndikimit të disa produkteve plastike në mjedis”.

Sa i takon legjislacionit shqiptar, siç është përmendur në shtjellimin e pyetjes 4.1.1, për mbetjet plastike ka vetëm një VKM, (VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, e ndryshuar me VKM nr. 232, datë 26.04.2018). Kjo e fundit është përafëruar pjesërisht me direktivën 2015/720/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 prill

⁴⁸ Direktiva Europiane e Mbetjeve 2008/98/EC, datë 19.11.2008, neni 9, “Parandalimi i mbetjeve”.

⁴⁹ Ligji nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 14, pika 2

⁵⁰<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/da9aa65e-b822-4dd8-83d8-b80310315be6/language-en>

⁵¹ <https://www.oneplanetnetwork.org/initiative/european-strategy-plastics-circular-economy>

2015, që amendon direktivën 94/62/KE, në lidhje me përdorimin e qeseve të lehta plastike mbajtëse.⁵²

Në këtë pasqyrë të shkurtër vihet re tendenca evropiane e reduktimit deri në eliminimin e produkteve një përdorimshe prej plastike si dhe tendenca e orientimit drejt modelit të ekonomisë qarkulluese.

Gjetje

4. Në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nuk janë përcaktuar afatet e vlerësimit dhe rishikimit të Programeve të Parandalimit të krijimit mbetjeve në mospërputhje me nenin 30 pika 1 të Direktivës së BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet”.

5. Legjislacioni shqiptar mbi mbetjet nuk ka asnjë strategji të dedikuar për mbetjet plastike ndryshe nga sa paraqitet në praktikën e mira, si për shembull Komisioni Evropian i cili ka hartuar strategji të dedikuar mbetjeve plastike.

Konkluzione

4. Duke mbajtur në vëmendje që vendi ynë në të ardhmen synon të jetë vend anëtar i BE-së, politikat, programet dhe strategjitë e zhvillimit janë mekanizmat për të arritur këtë qëllim. Edhe në fushën e menaxhimit të mbetjeve kuadri ligjor në tërësi është hartuar në harmoni me politikat e BE-së dhe konkretisht me Direktivën e BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet”. Përjashtim bën afati i rishikimit dhe vlerësimit të Programeve të Parandalimit të krijimit të mbetjeve të cilat në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nuk janë të përcaktuara, ndryshe nga Direktiva e BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet” e cila thotë se këto Programe duhen rishikuar të paktën çdo 6 vjet.

5. Ndryshe nga BE, në Shqipëri nuk është prodhuar asnjë dokument politik (strategji apo plan) dedikuar vetëm për mbetjet plastike. Mos prodhimi i dokumenteve të tilla politikë çënon, vështirëson dhe nuk garanton arritjen e objektivave kombëtare lidhur me menaxhimin e mbetjeve plastike.

Rekomandime

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe të propozojë në Këshillin e Ministrave ndryshimin e Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” duke përcaktuar afatet e vlerësimit dhe rishikimit të Programeve të Parandalimit të krijimit mbetjeve në përputhje me nenin 30 pika 1 të Direktivës së BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet”.

Qershor 2022

5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të hartuar dokumente politikë (strategji/plan veprimi) dedikuar vetëm mbetjeve plastike referuar praktikave të mira të BE-së të përshkruara më sipër gjatë shtjellimit të pyetjes.

Qershor 2022

4.2 A kanë zbatuar MTM dhe bashkitë kuadrin rregullator në fuqi për menaxhimin e mbetjeve plastike?

4.2.1 A janë marrë nisma nga Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan për zbatimin e legjislacionit lidhur me grumbullimin e ndarë të mbetjeve?

⁵² VKM nr. 232, datë 26.04.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 177, datë 06.03.2012 “Ambalazhet dhe mbetjet e tyre”

Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve plastike, grupi i auditimit ka vlerësuar procesin e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në vendin tonë duke u fokusuar kryesisht në Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë. Mbetjet të cilat nuk ndahen në burim është e vështirë ose e pamundur të riciklohen. Në vetvete procesi i riciklimit është i mundshëm vetëm nëse materialet e riciklueshme janë homogjene. Ndarja fundore e mbetjeve është e vështirë dhe jo plotësisht efektive si dhe çënon procesin e riciklimit. Prandaj, ndarja e mbetjeve në burim është shumë e rëndësishme sepse, ulet mundësia për ndërhyrje në procesin e grumbullimit të mbetjeve dhe përmirësohet dukshëm procesi i riciklimit të mbetjeve plastike. Sa më mirë që të funksionojë procesi i ndarjes së mbetjeve në burim, aq më shumë mbetje plastike grumbullohen dhe bëhet më i lehtë procesi i riciklimit si dhe bëhet e mundur ulja e dukshme e ndotjes nga plastika në mjedis.

Për një menaxhim më të mirë dhe të integruar të mbetjeve përfshirë edhe mbetjet plastike, politikat e hartuara dhe legjislacioni i miratuar kërkon grumbullimin e ndarë të mbetjeve. Për të bërë të mundur ndarjen e mbetjeve duhet që, NJQV-të të organizojnë apo të krijojnë një sistem grumbullimi të veçantë ose ndarje të mbetjeve në burim. Ndarja konsiston në ngritjen e infrastrukturës për grumbullimin e ndarë të mbetjeve duke zbatuar sistemin e grumbullimit të ndarë të mbetjeve në tre konteinerë si në figurën 8.⁵³

Figura 8: Si duhet të jetë struktura e grumbullimit të ndarë të mbetjeve



Kuadri rregullator i vendit tonë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve përcakton grumbullimin e diferencuar të mbetjeve si një nga hallkat kryesore të procesit të menaxhimit. Në nivel strategjik kombëtar parashikohet përmirësimi i performancës së përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve, deri në vitin 2020 nëpërmjet një rritjeje të sasisë së mbetjeve që shkon për riciklim dhe kompostim.⁵⁴ Për të rritur sasinë e mbetjeve që shkon për riciklim duhet të jetë efektiv procesi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve. Për të realizuar këtë proces NJQV-të duhej që brenda datës 31 dhjetor 2018 të kishin grumbulluar në mënyrë të diferencuar mbetjet, të paktën për këto rryma mbetjesh: plastikë, letër, metal dhe qelq.⁵⁵

VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, vendos afate për marrjen e masave të përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve si dhe objektiva specifike. Përkatësisht, NJQV-të duhet që të kenë ngritur infrastrukturën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve deri më **31 dhjetor 2016** dhe të gjitha NJQV-të duhet të kishin ngritur këtë infrastrukturë deri më **31 dhjetor 2018**. Detyrimet ligjore për NJQV-të shkojnë edhe më tej duke përcaktuar objektiva specifike që duhet të arrihen për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve sipas peshës. Për mbetjet plastike objektivi

⁵³ Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr. 175, datë 19.1.2011 seksioni 3.2.1, VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu IV, pika 5


⁵⁴ SKZHI-II 2015 – 2020, Kapitulli 12.2.2.

⁵⁵ Ligji Nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 18, pika 3.

që duhet të arrihet nga të gjitha NJQV-të është 22.5% të peshës së mbetjeve.⁵⁶ Arritja e këtyre objektivave duhet të parashikohet në Planet Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, në përputhje me nevojat dhe mundësitë, dhe ato janë të detyrueshëm për t'u arritur nga NJQV-të e çdo niveli.⁵⁷

Duke u bazuar në legjislacionin e MIM, grupi i auditimit ka identifikuar dhe ka paraqitur në skemën e mëposhtme hapat që duhet të ndjekë një proces efektiv i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe mbi këto hapa është bërë vlerësimi i procesit që kryhet aktualisht.

Skema 1: Hapat e një procesi efektiv të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve



Ndarja e mbetjeve në Bashkinë Tiranë

Menaxhimi i mbetjeve / ofrimi i shërbimit të pastrimit në Bashkinë e Tiranës bëhet duke e ndarë territorin në pesë zona shërbimi. Në trajtimin e bërë nga grupi i auditimit do të klasifikohet në dy zona sepse në zonën e njohur nga bashkia si “Zona e Kuqe” ka një infrastrukturë disi ndryshe për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, krahasuar me katër zonat e tjera.

“Zona e Kuqe” përfshin territorin brenda unazës së qytetit të Tiranës. Infrastruktura për grumbullimin e mbetjeve në këtë zonë është organizuar në grumbullimin e mbetjeve në dy rryma (foto 1): 1. Mbetje të riciklueshme (plastikë, qelq, metal, karton – konteineri i gjelbër), 2. Mbetje shtëpiake (konteineri blu).

Foto 1: Konteinerë për grumbullimin e mbetjeve në dy rryma



Rruga Abdyl Frashëri Tiranë (Grupi i Auditimit 2021)

⁵⁶ VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V

⁵⁷ Grupi i auditimit grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në nivel kombëtar e ka trajtuar duke i referuar analizës së dokumentacionit dhe të dhënave që ka marrë nga AKM dhe si raste studimore specifike ka marrë Bashkinë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan.

Gjendja e vendgrumbullimeve të mbetjeve në pjesë të ndryshme të qytetit të Tiranës

Nga vëzhgimet e grupit të auditimit në terren në territorin e Bashkisë Tiranë, vërehet se infrastruktura e vendgrumbullimeve të mbetjeve ndryshon dukshëm sa më shumë që të largohemi nga qendra e qytetit. Grupi i fotove në vijim paraqet përshkallëzimin e infrastrukturës së vendgrumbullimeve të mbetjeve në distanca të ndryshme nga qendra e qytetit.

Foto 2: Vendgrumbullimi i mbetjeve 3.7 km nga qendra e qytetit Tiranë



Burimi: Grupi i Auditimit 2020

Në një vëzhgim të thjeshtë të fotove, mund të shikohet që sa më shumë largohemi nga qendra e qytetit, aq më pak e organizuar dhe e mirëmbajtur është infrastruktura për grumbullimin e ndarë të mbetjeve. Në vijimësi të problematikave me ndarjen e mbetjeve në rryma të ndryshme vjen edhe grumbullimi i tyre nga e njëjta makinë grumbullimi. Nga dhjetëra vëzhgime që ka bërë në terren, në qytetin e Tiranës, grupi i auditimit ka konstatuar problematikë të theksuar lidhur me organizimin e konteinerëve në vendgrumbullimet e mbetjeve apo dhe problematika të tjera, si për shembull:

- Konteinerë të amortizuar;
- Konteinerë vetëm për një lloj rryme mbetjesh;
- Konteinerë që nuk e kanë të dukshëm emërtimin;
- Mbetje plastike dhe të rrymave të tjera jashtë konteinerëve;
- Hedhja e mbetjeve jo në konteinerët e duhur;
- Prania e individëve në vendgrumbullimet e mbetjeve që kryejnë aktivitetin e grumbullimit të plastikës apo llojeve të tjera të mbetjeve.

Ndarja e mbetjeve në Bashkinë Vlorë dhe Elbasan

Në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan infrastruktura e ngritur ofron grumbullimin e mbetjeve vetëm në një lloj kontejneri. Në të gjitha vendgrumbullimet e mbetjeve kontejnerët janë të njëjtë dhe të paemërtuar.

Foto 3 : Vendgrumbullim mbetjesh në Vlorë



Grupi i Auditimit 2020

Në krahasim me qytetin e Tiranës ku janë bërë disa përpjekje për të ngritur infrastrukturën me qëllim grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan nuk rezultojnë të jenë bërë përpjekje për të ngritur një infrastrukturë të tillë. Në mënyrë të përmbledhur në skemën në vijim paraqiten hapat e procesit aktual të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në të tre bashkitë që janë subjekt i auditimit.

Skema 2: Procesi aktual i grumbullimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan



Problematikës së mos grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në territorin ku ofrohet shërbimi i pastrimit, i shtohet edhe problematika tjetër e mos mbulimit të të gjithë territorit me shërbimin e pastrimit. Përkatësisht, për vitin 2017 shkalla e mbulimit të të gjithë territorit me shërbimin e pastrimit ka qenë 68.9% e territorit dhe në vitin 2018 65.7% e territorit.⁵⁸

Në përfundim, nga shqyrtimet, analizimet dhe vëzhgimet e bëra nga grupi i auditimit rezultojnë se, në asnjë nga bashkitë objekt auditimi (Tiranë, Vlorë dhe Elbasan) nuk është ngritur

⁵⁸ <file:///C:/Users/User/Downloads/mbetjet-e-ngurta-urbane-ne-shqiperi-2017.pdf>
http://www.instat.gov.al/media/6251/mbetjet-e-ngurta-urbane-2018_.pdf

infrastruktura e nevojshme për të siguruar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Gjithashtu, në analizimet e bëra nga grupi i auditimit të dokumentacionit të marrë nga MTM dhe AKM për vlerësimin e situatës në nivel kombëtar, grumbullimi i diferencuar i mbetjeve nuk realizohet në asnjë nga NJQV-të. VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” ka gjashtë vite që është miratuar dhe ende nuk ka gjetur zbatim në asnjë nga detyrimet që ajo përcakton. Edhe pse kjo VKM ngarkon me përgjegjësi NJQV-të, për të marrë masat e përshtatshme për të krijuar infrastrukturën me qëllim grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, nuk rezulton që nga NJQV-të të jenë ndërmarrë hapa për ta zbatuar atë (përfundimisht në Bashkia Tiranë, si e vetmja që është përpjekur të ngrejë infrastrukturën por siç dhe u trajtua më lart nuk ka patur sukses).

Mbledhja e Plastikës nga vendgrumbullimet e mbetjeve

Sikurse u trajtua edhe më sipër, grumbullimi i diferencuar i mbetjeve nuk ka rezultuar i suksesshëm në Bashkinë e Tiranës me gjithë përpjekjet që janë bërë. Ndërsa në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan ky proces nuk ka filluar asnjëherë. Një problematikë që shoqëron ndër vite procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve është aktiviteti i mbledhjes së disa rrymave të mbetjeve (plastikë, qelq, metal, etj.) në vendgrumbullimet e mbetjeve nga grupet e aktorëve informalë. Në aktivitetin e mbledhjes së plastikës mund të identifikojmë dy grupe informal:

- Grupi i parë informal është grupi i “*Mbledhësve të plastikës*” dhe materialeve të tjera të riciklueshëm nga kontejnerët në vendgrumbullimet e mbetjeve;
- Grupi i dytë janë “*Blerësit e plastikës*” që e blejnë plastikën nga “*Mbledhësit e plastikës*” dhe më pas e shesin tek bizneset që operojnë në fushë e riciklimit të plastikës.

Në territorin e Bashkisë Tiranë ushtrojnë aktivitetin e grumbullimit të plastikës nga individët, disa pika shumice. Ndonëse nuk ka të dhëna zyrtare, mbledhësit dhe grumbulluesit e plastikës operojnë lirshëm gjatë ditës veçanërisht në qytetet e Vlorës dhe Elbasanit.

Foto 4: Mbledhja e plastikës nga individë informal në qytetin e Tiranës 1.2 km nga qendra e qytetit



Burimi: Grupi i Auditimit 2020

Foto 5: Mbledhja e plastikës nga individë informal në qytetin e Vlorës



Grupi i Auditimit 2020

Në qytetin e Elbasanit kryejnë aktivitetin e grumbullimit të plastikës 11 kompani dhe problematika është e njëjtë. Grumbulluesit e plastikës i konstaton nëpër rrugët e qytetit dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre të pa shqetësuar nga strukturat e bashkisë.

Foto 6: Mbledhja e plastikës nga individë informal në qytetin e Elbasanit



Grupi i Auditimit 2020

Mbledhja e plastikës nga vendgrumbullimet e mbetjeve nga ana e këtyre grupeve është e mirë organizuar. Bashkitë si institucioni përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve që krijohen në territorin e tyre, nuk kanë kontroll mbi këtë problematikë e cila sjell efekte negative si në shëndetin e personave që ushtrojnë këtë aktivitet ashtu edhe në ndotjen e ambientit nga ndërhyrjet në kontejnerët e mbetjeve.

Me gjithë pretendimet e bashkive që janë ndërmarrë nisma informimi dhe ndërgjegjësimi, fakti është se këto bashki nuk kanë infrastrukturën minimale për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Kjo do të thotë, edhe nëse një prodhues mbetjesh është i ndërgjegjësuar dhe bën

ndarjen në burim të mbetjeve atij përsëri do t'i duhet t'i hedhë të gjitha mbetjet në një konteiner, dhe në përfundim do të jetë një makinë që do t'i grumbullojë ato.

Ambalazhet dhe mbetjet e tyre

Menaxhimi i ambalazheve dhe mbetjeve të tyre rregullohen me VKM-në 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”. Ky vendim synon:⁵⁹

- të parandalojë mbetjet nga gjenerimi i ambalazheve;
- të nxitë grumbullimin e diferencuar, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e mbetjeve nga ambalazhet, duke reduktuar sasinë e tyre që asgjësohen përfundimisht;
- të vendosë rregulla për prodhimin e ambalazheve dhe menaxhimin e mbetjeve të tyre në të gjitha fazat, si dhe të përcaktojë subjektet përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

Çdo prodhues i mallrave të ambalazuara apo ambalazhues që ushtron veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të rikuperojë dhe do të riciklojë minimalisht 22,5% të plastikës, duke llogaritur vetëm atë që riciklohet përsëri në plastikë, brenda kufijve kohorë, jo më vonë se data 31 dhjetor 2019.⁶⁰ Ky objektivi është i detyrueshëm për t'u arritur edhe në nivelin e çdo Njësie të Qeverisjes Vendore. NJQV-të janë përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij objektivi duke marrë të dhënat nga subjektet dhe duke i regjistruar ato në regjistrat përkatës që ato duhet të mbajnë. Më pas, brenda datës 28 shkurt të çdo viti duhet t'i raportojnë ato në AKM.⁶¹ AKM llogarit për të gjithë territorin e vendit të dhënat e dërguara nga NJQV-të dhe i përfshin rezultatet në bazën e të dhënave për Ambalazhet dhe Mbetjet e tyre.⁶²

Nisma për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike

Reduktimi i përdorimit të qeseve plastike mund të konsiderohet si nisma e vetme që MTM ka ndërmarrë lidhur me reduktimin e përdorimit të plastikës në vendin tonë. Kjo nismë mund të klasifikohet si një nismë që ka pasur një lloj ndikimi në ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi uljen e përdorimit të qeseve plastike në kryerjen e aktivitetit të tyre të përditshëm apo ripërdorimin e tyre në aktivitetet familjare. Kjo nismë është marrë në kuadër të miratimit të VKM-së 232 datë 26.4.2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” e cila ka për qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit publik përmes:

- Parandalimit të ndikimit negativ nga ambalazhet dhe mbetjet e tyre;
- Parandalimit të prodhimit të mbetjeve nga ambalazhet, nëpërmjet rritjes së ripërdorimit të tyre, riciklimit dhe formave të tjera të rikuperimit të mbetjeve nga ambalazhet;
- Reduktimit të sasive të këtyre mbetjeve që asgjësohen përfundimisht.

Gjetje

6. Bashkitë Vlorë dhe Elbasan dhe pjesërisht Bashkia Tiranë nuk kanë ngritur infrastrukturën e duhur për të mundësuar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në kundërshtim me VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

7. Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë marrë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu IV pika 1. Afatet

⁵⁹ VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”

⁶⁰ VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu X. Riciklimi dhe Rikuperimi

⁶¹ VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XII. Monitorimi dhe Raportimi

⁶² VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XII. Monitorimi dhe Raportimi, pika 5-6-7

ligjore për ngritjen e infrastrukturës së duhur që ofron grumbullimin e diferencuar të mbetjeve kanë përfunduar pa u përmbushur.

8. Kontratat që Bashkitë Elbasan dhe Vlorë, lidhur me kompanitë private që operojnë në këtë fushë, nuk janë ideuar dhe nuk janë mbështetur në Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, duke mos përcaktuar në specifikimet teknike të tyre detyrime për mënyrën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, gjë që do të mundësonte grumbullimin e ndarë të mbetjeve dhe respektimin e të gjithë kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

9. Kontratat e shërbimit të pastrimit për të tre Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk parashikojnë në specifikimet teknike grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në përputhje me Ligjin 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim.

10. Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk kanë arritur objektivin specifik të vendosur në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1, gërma c, për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike 22.5% të peshës së mbetjeve.

11. Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar formatin e raportimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 11 pika 6.

Konkluzione

6. Ndarja e mbetjeve në burim është parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve të miratuara me VKM nr. 175 datë 19.01.2011, në Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe më vonë me VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim. Bashkia Tiranë ka bërë përpjekje për të ngritur infrastrukturën e duhur për të ofruar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, por këto përpjekje nuk kanë rezultuar efektive, duke bërë akoma që mbetjet të hidhen të përziera dhe jo të ndara sipas rrymave të përcaktuara në kontejnerë. Edhe pse Bashkia Tiranë për zona të veçanta ka vendosur në pikat e grumbullimit të mbetjeve dy kontejnerë të ndryshëm (për grumbullimin e mbetjeve në dy rryma) hedhja e mbetjeve në kontejnerë nga qytetarët nuk bëhet në përputhje me llojin e mbetjeve që duhet të hidhen në këto kontejnerë. Gjithashtu, edhe grumbullimi i mbetjeve (nga kompanitë që realizojnë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve në Landfillin e Sharrës) nga të dy këto kontejnerë bëhet nga një automjet i vetëm, gjë që bën të mundur përzierjen e llojeve të ndryshme të mbetjeve përfshirë edhe plastikën. Bashkitë Vlorë dhe Elbasan nuk kanë ngritur infrastrukturën e duhur për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim. Këto bashki, ndryshe nga Bashkia e Tiranës nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të ngritur infrastrukturën në kundërshtim me detyrimet ligjore për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Gjatë vizitave në terren që grupi i auditimit ka ushtruar në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan (shoqëruar me foto të shumta), për të dyja këto Bashki nuk është vënë re në asnjë rast vendosja e kontejnerëve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

7. Kontratat e shërbimit të pastrimit për të tre Bashkitë (Tiranë, Elbasan dhe Vlorë) kanë mangësi sa i përket ideimit dhe hartimit të tyre, veçanërisht ato të Bashkisë Elbasan dhe Vlorë të cilat nuk e parashikojnë dhe nuk bazohen fare në Ligjin nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Mungesa e mbështetjes së këtyre kontratave në Ligjin nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” sjell edhe mos ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Bashkia e Tiranës edhe pse në hartimin e kontratave të tilla e ka përfshirë Ligjin nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në specifikimet teknike, nuk ka parashikuar asnjë

- detyrim për vendosjen e kontejnerëve që mundësojnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve për kompanitë private që kryejnë shërbimin e pastrimit dhe transportimit të mbeturinave për në destinacionin final. Vendosja e detyrimeve për mënyrën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në specifikimet teknike të kontratave të tilla do të mundësojë grumbullimin e ndarë të mbetjeve dhe respektimin e të gjithë kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
8. Objektivi për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike me 22.5% ndaj peshës totale të mbetjeve nga NJVQ-të është një objektivi i cili jo vetëm që nuk është arritur nga Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë por në këtë situatë, ku mungon totalisht infrastruktura dhe grumbullimi i diferencuar i mbetjeve është pothuajse inekzistent, e bën praktikisht të pamundur arritjen e këtij objektivi. Mungesa e arritjes së këtij objektivi është një tregues i qartë i inefektivitetit të këtyre tre bashkive të marra si rast studimor në këtë auditim.
 9. Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 11 pika 6 nuk ka hartuar formatin e raportimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Ky format është shumë i rëndësishëm sepse mbi të do të bëhet edhe raportimi i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

Rekomandime

6. Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë në kontratat për shërbimin e pastrimit të qytetit që do të lidhin në vijimësi me operatorët ekonomikë të marrin masa që të përfshijnë në procedurën e prokurimit dhe të sanksionojnë në këtë kontrata grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, në përputhje me Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” duke përcaktuar qartë në specifikimet teknike vendosjen e kontejnerëve të ndryshëm për të bërë të mundur grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim.

Me lidhjen e kontratave të reja dhe në vazhdimësi

7. Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë me ngritjen e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të marrin masa për arritjen e objektivit për përdorimin dhe riciklimin e plastikës në përputhje me VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1, gërma c.

Me lidhjen e kontratave të reja dhe në vazhdimësi

8. Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të hartuar formatin e raportimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve në përputhje me Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 11 pika 6.

Qershor 2022

4.2.2 A kanë marrë MTM dhe bashkitë nisma për të nxitur aktivitete informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre?

Problemi i menaxhimit të mbetjeve është një nga çështjet kryesore për çdo vend në ditët e sotme. Kjo vjen si rezultat i rritjes së konsumit dhe mënyrës së jetesës. Në shkallë vendi, në vitin 2018, sasia vjetore e mbetjeve urbane të menaxhuara për banorë, ishte 383 kg/banorë, ndërsa në vitin 2017 ishte 386 kg/banorë.⁶³ Sasitë e mëdha të mbetjeve që prodhon njeriu ndikojnë në prishjen e ekuilibrit natyror, prandaj një nga hapat e rëndësishëm për mbrojtjen e ekuilibrit natyror dhe uljen e ndotjes është edhe menaxhimi i integruar i mbetjeve. Menaxhimi efektiv i integruar i mbetjeve është një sfidë e institucioneve publike e cila është

⁶³file:///C:/Users/User/Desktop/Mbetjet%20Plastike/Projekt_Raporti_Mbetjet_Plastike/INSTAT_Mbetjet-e-ngurta-urbane-2018_.pdf

përcaktuar të menaxhohet me hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave, strategjive, planeve të menaxhimit, ligjit specifik, akteve nënligjore etj. Një nga drejtimet kryesore të menaxhimit efektiv të integruar të mbetjeve është edhe “*edukimi i publikut mbi rritjen dhe ndërgjegjësimin ndaj kërkesave ligjore*” dhe “*nxitja e sjelljes miqësore ndaj mjedisit*”.⁶⁴ Ndërgjegjësimi ndaj kërkesave ligjore nënkupton zbatimin e parimeve të menaxhimit të mbetjeve sipas hierarkisë së mbetjeve:⁶⁵

- Parandalimi i prodhimit të mbetjeve / reduktimi
- Ripërdorimi
- Riciklimi
- Incenerimi dhe rikuperimi i energjisë
- Asgjësimi /Landfilli

Nxitja e sjelljes miqësore ndaj mjedisit nënkupton:

- Rritjen e informimit të përgjithshëm mbi efektet negative që sjell hedhja e mbetjeve në ambient;
- Ndryshimin e zakoneve dhe sjelljeve të qytetarëve lidhur me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, reduktimin, riciklimin dhe asgjësimin.⁶⁶

Edukimi mjedisor i publikut lidhur me menaxhimin e mbetjeve, duhet të zhvillohet si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal në bashkëpunim të ngushtë me palët e interesit, përfaqësuesit e shoqërisë civile, qytetarët si dhe në institucionet arsimore.⁶⁷ Në SKMM “Edukimi i Publikut” është një nga katër shtyllat kryesore të zbatimit të saj.

Si pjesë e detyrimeve të institucioneve publike për informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut duhet të jetë edhe edukimi për mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre. Ndërmarrjen e fushatave të edukimit për mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre grupi i auditimit i ka parë si në këndvështrimin e fushatave specifike për mbetjet plastike ashtu edhe në këndvështrimin si pjesë e fushatave të përgjithshme mbi mjedisin dhe menaxhimin e mbetjeve.

Në nivel qendror, pra në nivel të MTM-së fushatat e edukimit mjedisor përqendrohen kryesisht në aktivitete lidhur me ditë të veçanta si Dita e Tokës, Dita Botërore e Mjedisit, apo fushata pastrimi në fillim të sezonit turistik etj.⁶⁸ Edhe për këto fushata grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion dokumentet vërtetuese nga ana e MTM-së.⁶⁹ Për të identifikuar nismat informuese, ndërgjegjësuere dhe edukuese grupi i auditimit i është referuar kronikave në media apo informacionit në faqen e internetit të ministrisë. Nga kërkimet dhe analizat e grupit të auditimit nuk rezultoi që MTM të ketë realizuar fushata informuese për publikun specifike për mbetjet plastike, përveç si pjesë e aktiviteteve të ndryshme për pastrimin e mjedisit.

Edukimi i publikut në Bashkinë Tiranë

Bashkia Tiranë e realizon shërbimin e pastrimit/menaxhimit të mbetjeve me anë të kontratave që lidh me kompani të ndryshme kontraktore. Bazuar në kontratat e shërbimit, kompanitë

⁶⁴ Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr. 175, datë 19.1.2011 seksioni 2.2.3.5.

⁶⁵ Piramida e Mbetjeve - Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr. 175, datë 19.1.2011 seksioni 2.4.1.

⁶⁶ Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr. 175, datë 19.1.2011 seksioni 3.1.2.1

⁶⁷ Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve – VKM Nr. 175, datë 19.1.2011 seksioni 3.1.2

⁶⁸ <https://ata.gov.al/2019/11/02/aksion-ne-kraste-klosi-operacioni-i-madh-i-pastrimit-nga-mentori-deri-ne-fillim-te-sezonit-te-ardhshem/>

⁶⁹ Email Drejtori i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit, 28.05.2021, ora 10.42.

kontraktore si pjesë e kontratës duhet të zhvillojnë edhe edukimin mjedisor të konsumatorëve.⁷⁰ Kontraktuesit duhet të zhvillojnë një program të “Edukimit Publik” për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Tiranës, për të rritur në maksimum pjesëmarrjen në programin e menaxhimit të mbeturinave duke vënë një theks të veçantë në grumbullimin e tyre në kontejnerë.⁷¹ Kontraktuesi për “Zonën e kuqe” – E.T., duhet të krijojë një program edukimi dhe fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për menaxhimin e mbetjeve në shkollat e qytetit të Tiranës si dhe në faqen e internetit të kompanisë. Grupi i auditimit nga materialet që i janë vënë në dispozicion dhe nga hulumtimi i faqes së internetit të kompanisë⁷² ka konstatuar që janë zhvilluar fushata informuese mbi mbetjet dhe riciklimin, në disa shkolla të qytetit dhe në faqen e internetit ka pak informacion rreth plastikës, riciklimit dhe ciklit të saj.⁷³

Katër kompanitë e tjera kontraktuese që mbulojnë katër zonat e tjera të qytetit, duhet të kryejnë një herë në 6 muaj programin e “Edukimit ambiental” dhe “Edukimin e publikut” i cili duhet të jetë sipas idesë, përcaktimeve dhe i miratuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës.⁷⁴ Edukimi mund të realizohet nëpërmjet mediave dhe shpërndarjen e materialeve informuese të paktën një herë në gjashtë muaj. Materialet informuese duhet të jenë në formën e fletëpalosjeve apo broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e ndotjes, *parandalimin e saj* si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes.⁷⁵ Në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor, Operatori i zonës duhet të përgatisë dhe të promovojë spote publicitare që përcjellin mesazhin e Bashkisë Tiranë në këtë kontekst.⁷⁶ Kontrata parashikon penalitete nëse kontraktuesi nuk përmbush detyrimet e kontratës për. Bashkia Tiranë si autoriteti mbikëqyrës për zbatimin e kushteve të kontratës nuk rezulton që të ketë mbikëqyruar zbatimin e neneve që lidhen me Edukimin ambiental dhe Edukimin e publikut si dhe të ketë marrë masa ndaj kompanive kontraktuese në rast të mos zbatimit të detyrimeve të neneve 17 dhe 35 të kontratës së shërbimit.⁷⁷

Nga pesë kompani që mbulojnë shërbimin e pastrimit në qytetin e Tiranës, vetëm dy kompani kanë hartuar një program edukimi ambiental të publikut, për periudhën objekt auditimi (“A. I. G.” dhe “E. T.”) ndërsa kompanitë e tjera nuk kanë program të edukimit ambiental.

Edukimi i publikut në Bashkinë Vlorë

Bashkia Vlorë e mbulon shërbimin e pastrimit të qytetit nga një kompani kontaktore (“D. shpk”). Kompania kontraktore ka detyrimin të realizojë programin e “Edukimit publik” të konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Vlorës duke vënë theks të veçantë në grumbullimin e mbetjeve në kontejnerë dhe respektimin e orareve përkatëse për hedhjen e mbetjeve.⁷⁸ Programet e edukimit ambiental duhet të kryhen një herë në gjashtë muaj dhe konsistojnë në

⁷⁰ Kontrata e Shërbimit të Pastrimit lidhur midis Bashkisë Tiranë dhe “A. G. – shpk” - Zona I, “K. shpk” – Zona II, “A. I. G.” – Zona III, “F. shpk” – Zona IV, neni 17 Kontrata e Shërbimit të Pastrimit për “Zonën e kuqe”, E. T., lidhur në datë 13.09.2016, prot.27496, neni 10

⁷¹ Kontrata e Shërbimit të Pastrimit lidhur midis Bashkisë Tiranë dhe “A. G. – shpk” - Zona I, “K. shpk” – Zona II, “A.I. G.” – Zona III, “F. shpk” – Zona IV, neni 17 Kontrata e Shërbimit të Pastrimit për “Zonën e kuqe”, E. T., lidhur në datë 13.09.2016, prot.27496, neni 10

⁷² <http://www.eco-tirana.al/>

⁷³ http://www.eco-tirana.al/?page_id=6341

http://www.eco-tirana.al/?page_id=6134

⁷⁴ Kontrata e Shërbimit të Pastrimit lidhur midis Bashkisë Tiranë dhe “A. G. – shpk” - Zona I, “K. shpk” – Zona II, “A. I. G.” – Zona III, “F. shpk” – Zona IV, neni 17, pika 1, neni 35

⁷⁵ Kontrata e Shërbimit të Pastrimit lidhur midis Bashkisë Tiranë dhe “A. G. – shpk” - Zona I, “K. shpk” – Zona II, “A. I. G.” – Zona III, “F. shpk” – Zona IV, neni 35, pika 9

⁷⁶ Kontrata e Shërbimit të Pastrimit lidhur midis Bashkisë Tiranë dhe “A.G. – shpk” - Zona I, “K. shpk” – Zona II, “A. I. G.” – Zona III, “Fusha shpk” – Zona IV, neni 35, pika 9

⁷⁷ Rezultatet e vëzhgimeve të grupit të auditimit në terren janë trajtuar gjerësisht në pyetjen 1.2.1

⁷⁸ Kontrata e Shërbimit të Pastrimit të Qytetit Vlorë 2015-2019, neni 11

prodhimin dhe transmetimin e një spoti televiziv dhe shpërndarjen e broshurave dhe fletëpalosjeve informative.⁷⁹ Bashkia Vlorë duhet të sensibilizojë në mënyrë të herë pas hershme banorët nëpërmjet lajmërimeve zyrtare ose mediave të shkruara dhe elektronike për mbajtjen pastër të ambientit.

Për periudhën objekt auditimi (2017-2019) grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion nga Bashkia Vlorë dokumente që vërtetojnë nëse kompania kontraktore ka zbatuar detyrimet e plota (si për shembull Programet e Edukimit Publik) të nenit 11 të kontratës së shërbimit. Konkretisht, për reduktimin e përdorimit të plastikës nuk ka fushata ndërgjegjësimit të ndërmarra nga Bashkia Vlorë apo nga kompania kontraktore që ofron shërbimin e pastrimit në qytetin e Vlorës.⁸⁰

Edukimi i publikut në Bashkinë Elbasan

Edhe Bashkia Elbasan sikurse bashkitë e tjera të trajtuara më lart, shërbimin e pastrimit e mbulon nëpërmjet kompanisë kontraktore “V. I.” sh.p.k. Kompania ka detyrim të realizojë programin e “Edukimit publik” (Detyrimet e kompanisë kontraktore janë të njëjta si ato të trajtuara më lart në Bashkinë Vlorë) për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Elbasanit.

Grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion programi i edukimit për periudhën objekt auditimi (2017-2019) dhe dokumente faktuar/vërtetuese për të treguar që kompania i ka përmbushur detyrimet kontraktore lidhur me hartimin dhe kryerjen e programit të “Edukimit publik”. I vetmi dokument që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, ishte fletë-palosja e kompanisë kontraktore mbi ofrimin e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit.

Gjetje

12. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka ndërmarrë nisma informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre duke mos përmbushur objektivat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve miratuar me VKM nr. 175 datë 19.01.2011, paragrafi 3.1.2.1 “Fushata për informimin e publikut”.
13. Në Bashkinë Tiranë programi i Edukimit Ambjental dhe Edukimit të Publikut është realizuar pjesërisht vetëm nga një kompani (E. T.) nga pesë të tilla që ofrojnë shërbimin e pastrimit në qytetin e Tiranës në kundërshtim kjo me kushtet e kontratës së lidhur me kompanitë kontraktore.
14. Në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan kompanitë kontraktore që mbulojnë shërbimin e pastrimit nuk kanë hartuar Programet e Edukimit të Publikut në shkelje të detyrimeve kontraktore dhe si rezultat nuk kanë ndërmarrë nisma informuese, ndërgjegjësuere dhe edukuese lidhur me mbetjet (përfshirë dhe mbetjet plastike) dhe reduktimin e tyre.
15. Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë marrë asnjë masë për të informuar përdoruesit e ambalazheve dhe në mënyrë të veçantë konsumatorët, për zbatimin e detyrimeve të VKM-së nr. 177, datë 6.3.2012, 2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XIII.

Konkluzione

10. Edukimit të publikut lidhur me mjedisin, mbetjet në tërësi si dhe mbetjet plastike në veçanti i kushtohet shumë pak vëmendje nga ana e institucioneve përgjegjëse (MTM, Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan). Nismat e ndërmarra për edukimin janë të rralla, dhe të përgjithshme mbi çështje të ndryshme të mjedisit dhe rrallë ndonjë nismë e veçantë për mbetjet plastike. Edukimi i publikut është çelësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me ndarjen e mbetjeve në

⁷⁹ Kontrata e Shërbimit të Pastrimit të Qytetit Vlorë 2015-2019, neni 11

⁸⁰ Përgjigjet e pyetësorit Bashkia Vlorë

burim, grumbullimin e diferencuar dhe menaxhimin e mbetjeve sipas piramidës së menaxhimit e cila si mënyrën më optimale të menaxhimit rekomandon reduktimin e prodhimit të mbetjeve.

11. Në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan kanë munguar tërësisht nismat informuese, ndërgjegjësuere dhe edukuese të publikut lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre. Këto nisma duhet të ishin pjesë e programeve të Edukimit publik që në këto bashki nuk janë realizuar nga kompanitë kontraktore në kundërshtim me kushtet e kontratës. Në kushtet e kontratës me kompanitë që mbulojnë shërbimin e pastrimit në këto dy qytete neni mbi programet e Edukimit të Publikut nuk parashikon edukimin mbi rëndësinë e parandalimit të prodhimit të mbetjeve në tërësi ku përfshihet edhe plastika. Theksojmë se edukimi i publikut në reduktimin e përdorimit të plastikës, është qasja më e përhapur sot në Evropë për sa i takon menaxhimin e mbetjeve plastike, sepse është mënyra më efektive për të zbutur dëmet që plastika sjell në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.
12. VKM nr. 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” ka nëntë vite që është miratuar. Nga konstatimet e grupit të auditimit rezulton se Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë bërë asnjë informim për përdoruesit e ambalazheve mbi rolin dhe rëndësinë që ata kanë në procesin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të ambalazhit, reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të tyre.

Rekomandime

9. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit menjëherë pas hartimit të Programeve për Parandalimin e prodhimit të mbetjeve, ku mbetjet plastike janë pjesë e këtyre programeve, të hartojë një plan dhe të ndërmarrë fushata për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, lidhur me rëndësinë e parandalimit të prodhimit të mbetjeve, përfshirë këtu edhe mbetjet plastike. Hartimi i planit të edukimit dhe ndërmarrja e fushatave duhet të dokumentohen nga strukturat përkatëse të Ministrisë.

Qershor 2022 dhe në vazhdimësi

10. Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan të marrin masa që operatorët ekonomikë të hartojnë dhe të zbatojnë programet e “Edukimit të publikut” në përputhje me detyrimet kontraktuale.

Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

11. Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan të marrin masa për të informuar përdoruesit e ambalazheve sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.

Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

4.2.3 A kanë informacion qytetarët lidhur me ndarjen e mbetjeve plastike në burim dhe dëmeve që shkaktohen prej tyre?

Si fillim duhet të sqarojmë se pyetja audituese 4.2.3 është një pyetje përshkruese. Edhe pse këshillohet që formulimi i pyetjeve të auditimit të bëhet në mënyrë normative apo analitike, hartimi i pyetjeve përshkruese ndonjëherë është më i dobishëm veçanërisht kur po auditohet një fushë për të cilën kemi mungesë informacioni siç është edhe rasti në fjalë.⁸¹ Për trajtimin e kësaj pyetjeje audituese, grupi i auditimit hartoi një pyetësor për publikun e gjerë, i cili u shpërnda online për një periudhë 10 ditore. Qëllimi i këtij pyetësori ishte për të parë se sa qytetarët janë në dijeni mbi institucionet që kanë detyrimin ligjor për të menaxhuar mbetjet urbane në të cilat bëjnë pjesë edhe mbetjet plastike, për të parë se sa të kënaqur janë qytetarët


⁸¹ Vendim nr. 78, datë 30/06/2020 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit, paragrafi 25, fq 59.

me shërbimin që i bëhet atyre sa i përket menaxhimit të mbetjeve si dhe për të parë sa të ndërjegjësuar dhe informuar janë ata lidhur me efektet shëndetësore që mund të shkaktojnë mbetjet plastike. Pyetësi u ndërtua me pyetje të karakterit socio-ekonomik dhe shëndetësor. Nga ky pyetësor u përfytuan **1,051** përgjigje, të cilat më pas u përpunuan nga grupi i auditimit. Pyetësi përmbajti në total 17 pyetje. Nga përgjigjet rezultoi se 543 qytetarë ose 52 % e ishinqytetarë të Qarkut të Tiranës, 84 qytetarë ose 8 % e përgjigjeve nga Qarku i Durrësit, 55 qytetarë ose 5% e përgjigjeve nga Qarku Fier, 52 qytetarë ose 5% e përgjigjeve nga Qarku Lezhë dhe pjesa tjetër nga qarqet e tjera të vendit. Në përgjigjet e dhëna rezultoi se për grupmoshën 18-24 vjeç janë përgjigjur 547 qytetarë ose 52% e përgjigjeve, për grup moshën 25-59 vjeç janë përgjigjur 361 qytetarë ose 34% e përgjigjeve, për grup moshën nën 18 vjeç janë përgjigjur 141 qytetarë ose 14% e përgjigjeve dhe për grup moshën mbi 60 vjeç është përgjigjur vetëm 1 qytetar.

Në përgjigjet e këtij pyetësi, vihet re se 882 përgjigje ose 84% e totalit nuk i ndajnë mbetjet sipas rrymave, madje 642 përgjigje ose rreth 61% e tyre nuk kanë njohuri se mbetjet urbane duhen ndarë në burim sipas legjislacionit shqiptar dhe 706 përgjigje ose 67% nuk kishin dijeni të saktë mbi institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane. Sipas pyetësit rezultoi se 198 përgjigjeve ose 19% nuk kishin dëgjuar asnjëherë për hierarkinë e mbetjeve dhe në rast se analizojmë këtë edhe në funksion të grup moshës rezultoi se 121 përgjigje i përkasin grup-moshës nën 18 vjeç. Kjo shifër tregon edukim të dobët mjedisor në programet mësimore ose edukative në nivel para universitar. Gjithashtu rezultoi se në 786 përgjigje ose 75% nuk janë këshilluar ndonjëherë nga Bashkia ose institucione të tjera lidhur me mënyrën se si duhet të hidhen mbeturinat në kontejnerë. Sipas këtij pyetësi për 890 përgjigje ose 85% kanë deklaruar se nuk kanë kosha të identifikuar sipas rrymave të ndryshme të mbetjeve. Edhe pse nga përgjigjet e dhëna 345 përgjigje ose 33% dëshmonin se kishin dijeni se cili ishte institucion përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve urbane, vetëm 91 prej tyre ose 9% kanë përcaktuar “Bashkinë” si institucion përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve urbane, ndërsa pjesa tjetër nuk kishte dijeni të plotë mbi institucionin përgjegjës për menaxhimin e tyre. Në përgjigjen e pyetësit rezultoi se 1014 persona ose 97% janë përgjigjur se plastika dëmton shëndetin e njeriut në tërësi dhe mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur dhe grafikisht gjenden pyetjet kryesore të këtij pyetësi.

1. A keni dijeni se cili është institucioni përgjegjës për menaxhimin (grumbullimin, transportimin, trajtimin, asgjësimin) e mbetjeve urbane?




2. A jeni këshilluar ndonjëherë nga Bashkia ose ndonjë institucion tjetër lidhur me mënyrën se si duhen ndarë mbeturinat, para se të hidhen në kontejnerë?

Këshillim për ndarjen ne rryma




3. A janë të identifikueshëm koshat e vendosur pranë banesës tuaj nga Bashkia se ku duhet të hidhni llojet e ndryshme të mbetjeve?

Kosha të identifikuar




4. A keni dëgjuar ndonjëherë për hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve?

Hierarkia e mbetjeve




5. A i ndani mbetjet urbane sipas rrymave apo llojeve të ndryshme që ato përbëhen?


Ndarja sipas rrymave




6. A keni dijeni se si duhen ndarë mbetjet urbane në përputhje me standardet dhe legjislacionin shqiptar?




7. A keni dëgjuar nga institucione të ndryshme lidhur me dëmet mjedisore ose shëndetësore që mund të shkaktojnë mbetjet plastike?




8. A mendoni se plastika ka efekte negative në shëndetin e njeriut?




9. A keni dëgjuar ndonjëherë për mikroplastikën në mjedisin ujor?




10. A mund të çojë ndotja nga plastika në probleme me mushkërinë?




11. A mund të çojë ndotja nga plastika në probleme me lëkurën?



12. A mund të çojë ndotja nga plastika në probleme me riprodhimin?



13. A mund të çojë ndotja nga plastika në probleme me zemrën?



4.3A ka monitoruar MTM zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve plastike?

Monitorimi është një sistem i vëzhgimit të vazhdueshëm të fenomeneve dhe proceseve që ndodhin në mjedis dhe shoqëri, rezultatet e të cilave ndihmojnë në vlerësimin e ngjarjeve të caktuara: për zhvillimin e strategjive dhe teknikave në procese të caktuara jetësore dhe mjedisore; për të përmirësuar procesin e vendimmarrjes dhe për të informuar publikun. Thënë ndryshe *Mbledhja sistematike e informacionit që i mundëson aktorët për të kontrolluar nëse një nismë është në rrugën e duhur apo po arrin të plotësojë disa objektiva*. Lidhur me zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve plastike, MTM ka detyrimin ligjor ta monitorojë dhe ta raportojë këtë proces.⁸²

4.3.1 A ka MTM të dhëna lidhur me sasinë, burimin dhe trajtimin e mbetjeve plastike?

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti përgjegjës që administron dhe përditëson statistikat për krijimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve në vendin tonë.⁸³ Referuar Ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 60, pika 2, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit çdo 3 vjet duhet të përgatisë dhe publikojë një raport për statistikat e mbetjeve në Shqipëri. MTM, mbështetur në të dhënat e AKM, harton raportin për zbatimin e Vendimit nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, si pjesë integrale të raportit për zbatimin e Ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, të parashikuar në pikën 1, të nenit 66, brenda 30 Tetorit 2017, dhe më pas çdo tre vjet.

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve [SKMM] dhe [PKMM] janë miratuar në vitin 2011. Me qëllim vënie në zbatim të objektivave të saj është i rëndësishëm bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve që kanë dhe ndajnë përgjegjësi në menaxhimin e mbetjeve. Disa nga aktorët kryesorë që mund të përmendim janë: NJQV-të, disa nga ministritë e linjës, organet doganore, palët e interesit, shoqëria civile etj. MTM duhet që të bashkërendojë komunikimin midis palëve si një mjet efektiv për të vënë në zbatim SKMM. Në këtë kuadër duhet të organizohen konferenca, seminare, takime, konsultime, fushata informuese etj. të cilat duhet të sigurojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve kryesorë dhe në veçanti, autoriteteve lokale që të nxisin zbatimin e kuadrit ligjor për MIM. Në shqyrtim të këtyre detyrimeve që ka MTM lidhur me monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të SKMM, grupi i auditimit konstaton se për periudhën objekt auditimi nuk janë organizuar takime, seminare, konsultime apo fushata informimi me aktorët e përfshirë sidomos me NJQV-të, me qëllim nxitjen e zbatimit të kuadrit ligjor; njohjen e problematikave që hasen nga bashkitë për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe përmirësimet e problematikave të konstatuara.

Të dhënat për ambalazhet dhe mbetjet e tyre

Çdo prodhues i mallrave të ambalazuara apo ambalazhues që ushtron veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të rikuperojë dhe riciklojë minimalisht 22,5% të plastikës, duke llogaritur vetëm atë që riciklohet përsëri në plastikë jo më vonë se data 31 dhjetor 2019.⁸⁴ Ky objektivi është i detyrueshëm për t’u arritur edhe në nivelin e çdo Njësie të Qeverisjes Vendore. Prodhuesi i mallrave të ambalazuara dhe prodhuesi i ambalazheve brenda datës 31 janar të çdo viti, raportojnë në NJQV-të përkatëse të dhënat e regjistruara për vitin paraardhës, mbi sasinë e ambalazheve të mbetjeve.⁸⁵ NJQV-të llogaritin të dhënat e

⁸² VKM 175/2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”, Paragrafi 1.5

⁸³ Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 60, pika 1

⁸⁴ VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu X

⁸⁵ VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 1


marra e të regjistruara nga subjektet, për gjithë territorin nën juridiksionin e tyre për vitin kalendarik paraardhës dhe i regjistrojnë ato në regjistrat e tyre, të krijuar për këtë qëllim.⁸⁶ NJQV-të raportojnë, brenda datës 28 shkurt të çdo viti në AKM, shifrat e realizuara të grumbullimit për vitin paraardhës, mbi sasinë e ambalazheve të mbetjeve në total për gjithë territorin nën juridiksionin e tyre.⁸⁷ Institucion tjetër që duhet të raportojë në AKM është edhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e cila brenda datës 28 shkurt të çdo viti, raporton për importet dhe eksportet e mallrave ambalazh dhe të mallrave të ambalazuara, sasi të ambalazheve të prodhuara dhe të hedhura në treg për vitin paraardhës, në bazë të peshës së tyre.⁸⁸ Pasi të gjitha institucionet e sipërcituara kanë raportuar në AKM, ajo llogarit për gjithë territorin e vendit dhe regjistron në regjistrat e saj, të krijuar për këtë qëllim.⁸⁹

- peshën e përgjithshme të mbetjeve të ambalazheve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar;
- peshën e përgjithshme të mbetjeve të ambalazheve sipas llojit të materialit përbërës.

AKM i përfshin rezultatet e grumbullimit të mbetjeve të ambalazheve të shprehura në % në Raportet e Gjendjes së Mjedisit⁹⁰ si dhe krijon, administron dhe përditëson bazën e të dhënave për ambalazhet dhe mbetjet e tyre.⁹¹

MTM i vendos rezultatet e këtij regjistrimi e monitorimi në dispozicion të publikut, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.⁹²

Të dhënat për reduktimin e qeseve plastike



AKM, në bashkëpunim me Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit, organet doganore e tatimore dhe Inspektoratin Qendror Teknik, mbledh dhe administron në mënyrë periodike vjetore informacionin e dërguar nga NJQV-të mbi sasinë e qeseve plastike mbajtëse, të kategorizuara sipas përcaktimeve të VKM-së 232, datë 26.04.2018, në qarkullim në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe sasinë e tyre të përdorur në industrinë ricikluese.”⁹³ Qeset plastike mbajtëse, të lejuara për t’u hedhur në treg sipas përcaktimeve të këtij vendimi, mund të ofrohen në pikat e shitjes së mallrave apo produkteve, vetëm kundrejt një pagese të posaçme të identifikuar në faturën apo kuponin tatimor.”⁹⁴ MTM është institucioni i nivelit më të lartë përgjegjës për zbatimin e detyrimeve që lindin nga VKM 232, datë 26.04.2018.

Skema 3: Procesi i grumbullimit dhe përpunimit të dhënave mbi mbetjet plastike

⁸⁶ VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 2

⁸⁷ VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 3

⁸⁸ VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 4

⁸⁹ VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 5

⁹⁰ VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 6

⁹¹ VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 7

⁹² VKM Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 9

⁹³ VKM Nr. 232, datë 26.04.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 177, Datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, pika 5

⁹⁴ VKM Nr. 232, datë 26.04.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 177, Datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, pika 7

Në mënyrë të përmbledhur, aktorët kryesorë në zbatimin e kuadrit ligjor për grumbullimin, përpunimin dhe administrimin e të dhënave mbi mbetjet plastike janë: Njësitë e Qeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (skema 3).

Të krijosh një bazë të dhënash të plotë në të gjithë komponentët e saj, si burimin e mbetjeve plastike, sasinë e gjeneruar, trajtimin e tyre dhe import-eksportet, duhen që të gjithë institucionet e sipërcituara të zbatojnë detyrimet ligjore për të raportuar në AKM brenda afateve dhe sipas formateve të përcaktuara.

Grupi i auditimit konstatoi se NJQV-të që janë institucionet përgjegjëse për grumbullimin direkt të të dhënave mbi mbetjet që prodhohen dhe menaxhohen në territorin e tyre dhe duhet t'i raportojnë ato në AKM, nuk i zbatojnë ose i zbatojnë pjesërisht detyrimet ligjore për sa i takon të dhënave mbi mbetjet, ku mbetjet plastike janë një nga rrymat. AKM nuk merr informacionin e plotë dhe të saktë lidhur me sasinë e mbetjeve plastike të gjeneruara në nivel kombëtar, gjë që rezulton në statistika jo të plota dhe të pasakta nga ana e saj.

Të dhënat e raportuara nga NJQV-të nuk rezultojnë nga peshimi i drejtpërdrejtë i mbetjeve të prodhuara sipas rrymave. Të dhënat llogariten duke shumëzuar koeficientet me sasinë e gjeneruar të mbetjeve. Sasia e gjeneruar e mbetjeve është llogaritur duke shumëzuar numrin e banorëve me koeficientin e mbetjeve urbane nga 0.7-1.5 kg/banorë në varësi të zhvillimit ekonomik të qytetit. Theksojmë se, kjo mënyrë e llogaritjes së të dhënave (sipas koeficienteve dhe jo duke u peshuar direkt) realizohet duke marrë në konsideratë vetëm banorët rezident të regjistruar në Gjendjen Civile. Përrjashtim nga kjo mënyrë llogaritje bën Bashkia e Tiranës dhe Elbasanit që të dhënat i marrin nga peshimet direkte që bëhen në landfill dhe incenerator, por edhe këto të dhëna nuk janë plotësisht të sakta pasi në landfill apo incenerator peshohet sasia totale e mbetjeve dhe bëhen llogaritjet, nuk peshohen të ndara sipas rrymave.

Tabela 7: Sasia e mbetjeve plastike të gjeneruara sipas qarqeve për vitet 2017-2018-2019-2020

NR	Qarku	Sasia e mbetjeve plastike (KG ⁹⁵)			
		Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020 ⁹⁶
1	Tiranë	896,211	N/A	2,871,998	5,870
2	Durrës	21,456,000	16,612,000	N/A	N/A
3	Shkodër	6,823,930	740,248	5,110,256	573,362
4	Vlorë	6,069,170	6,201,870	7,364,140	9,373,734
5	Elbasan	6,949,700	6,603,500	5,556,971	4,896,579
6	Korçë	8,533,800	4,539,000	4,620,986	2,061,908
7	Fier	4,894,467	7,275,457	3,800,409	283,319
8	Gjirokastrë	1,118,360	2,044,670	628,279	21,658
9	Lezhë	951,000	1,944,000	2,008,250	1,243,600
10	Dibër	210,798	215,243	565,215	496,174
11	Berat	2,186,000	3,149,000	1,896,225	4,306,226
12	Kukës	463,000	1,641,000	N/A	1,550,000
Totali Mbetje Plastike		60,552,436	50,965,988	34,422,729	24,812,430

*Përpunuar nga grupi i auditimit. Të dhënat AKM⁹⁷

Sasia vjetore e mbetjeve plastike të gjeneruara për banorë në shkallë vendi ka pësuar luhatje nga viti në vit, për shembull: në vitin 2016 çdo shqiptar ka prodhuar mesatarisht 37.3 kg mbetje plastike/banorë, në vitin 2017 - 64.8 kg/banorë, në vitin 2018 - 37 kg/banorë dhe në

⁹⁵ Shënim: Termi N/A nënkupton se Bashkitë përkatëse nuk kanë raportuar në AKM për të dhëna lidhur me mbetjet plastike.

⁹⁶ Email AKM, datë 06.05.2021 ora 10:45

⁹⁷ AKM, Raporti i Gjendjes së Mjedisit, 2017, 2018, 2019.


vitin 2019 - 32.1 kg/banorë.⁹⁸ Sasia mesatare e mbetjeve plastike të gjeneruara në Evropë për vitin 2017 është 32.7 kg/banorë, për vitin 2018 është 33.45 kg/banorë por nga statistikat prej vitit 2005 e deri në vitin 2018 vlerësohet mesatarisht që një qytetar evropian ka prodhuar 31 kg mbetje plastike në vit.⁹⁹

Riciklimi

Niveli i tretë në Hierarkinë e mbetjeve është Riciklimi. Subjektet private prodhues të mbetjeve, në raportin e vetëmonitorimit nuk raportojnë sipas detyrimeve, pra nuk raportojnë sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe sasinë që shkon për riciklim. AKM ka vetëm sasinë totale të mbetjeve plastike të gjeneruara nga secila bashki sipas të dhënave që kanë deklaruar dhe jo sasinë e mbetjeve plastike të ricikluar nga kjo sasi e gjeneruar. Si përfundim nuk kemi të dhëna mbi sasinë e riciklimit të mbetjeve plastike në vend.

Eksportet

Grafik nr. 6: Import – Eksport plastike



Burimi: MTM, Përpunoi, Grupi i Auditimit

Të dhënat që MTM ka mbi sasinë e eksportit të mbetjeve plastike janë për vitet 2017-2020, eksport i realizuar kryesisht në vendet e rajonit. MTM lëshon autorizime me afat 1 vjeçar atyre subjekteve që kanë Licenca të lëshuara nga AKM dhe kanë si aktivitet edhe transportin/eksportin e plastikës. Nga evidencat e siguruar u vu re se MTM ka pajisur me autorizim për eksport të mbetjeve plastike: 5(pesë) subjekte në vitin 2017 të cilat kanë eksportuar së bashku 17,700 ton plastikë, 7(shtatë) subjekte në vitin 2018 me 16,000 ton plastikë, 4(katër) subjekte në vitin 2019 me 11,500 ton dhe 5(pesë) subjekte në vitin 2020 me 22,700 ton plastikë. Në total për periudhën nën auditim MTM ka lëshuar 21(njëzetë e një) Autorizime, nga të cilat 8(tetë) autorizime u përkasin 8(tetë) subjekteve që janë pajisur vetëm 1(një) herë, 1(një) subjekt është pajisur 2(dy) herë, 1(një) subjekt është pajisur 3(tre) herë dhe 2(dy) subjekte janë pajisur çdo vit me autorizim në periudhën 2017-2020, duke treguar një vazhdimësi të aktivitetit të tyre eksportues. Ndërsa pjesa i përket **Importeve** sasia e ambalazheve plastike të importuara është më e madhe se ajo e eksporteve. Nga evidencat grupi i auditimit konstatoi se në ndryshim nga eksportet ku vlera e sasisë së tyre ka trend të ndryshueshëm nga viti në vit, importet për periudhën 2017-2020 kanë trend rritës. Në vitin 2020 është raportuar sasia më e madhe e plastikës së importuar për periudhën 2017-2020 në

⁹⁸ <file:///C:/Users/User/Downloads/mbetjet-e-ngurta-urbane-ne-shqiperi-2017.pdf>

[file:///C:/Users/User/Desktop/Mbetjet%20Plastike/Projekt Raporti Mbetjet Plastike/INSTAT Mbetjet-e-ngurta-urbane-2018_.pdf](file:///C:/Users/User/Desktop/Mbetjet%20Plastike/Projekt%20Raporti%20Mbetjet%20Plastike/INSTAT%20Mbetjet-e-ngurta-urbane-2018_.pdf)

⁹⁹ <https://www.statista.com/topics/5141/plastic-waste-in-europe/>

<https://www.dw.com/en/plastic-waste-and-the-recycling-myth/a-45746469>

vlerën 112,407.280 ton ose 4.9 herë më shumë se eksporti i këtij viti, më e vogël në vitin 2019 me 103,019.629 ton ose 8.9 herë më shumë se eksporti, për vitet 2017 e 2018 respektivisht me 37,771.386 ton ose 2.1 herë më shumë dhe 37,022.384 ton ose 2.3 herë më shumë se eksporti i viteve respektive..¹⁰⁰

Ligji nr.10463/2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” përcakton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre. MTM është autoriteti përgjegjës për monitorimin e zbatimit të detyrimeve që përcakton ligji për MIM. Raportet e përgatitura nga strukturat e ministrisë duhet të publikohen në faqen zyrtare të ministrisë dhe t’i vihen në dispozicion publikut.¹⁰¹

Gjetje

16. Nga auditimi u konstatua se të dhënat që Agjencia Kombëtare e Mjedisit disponon dhe që janë publikuar në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (2017- 2019) lidhur me sasinë totale të mbetjeve plastike që prodhohen në Shqipëri, nuk janë të sakta dhe të plota, sepse jo të gjitha Bashkitë kanë raportuar çdo vit dhe jo të gjitha subjektet private që gjenerojnë mbetje plastike raportojnë rregullisht, në kundërshtim me VKM nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre, kreu XII, pika 1 dhe 3.
17. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka të dhëna të sakta dhe nuk ka publikuar në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitet 2017-2019, mbi sasinë e riciklimit të mbetjeve plastike, në kundërshtim me VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, pika 6.
18. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka të dhëna mbi rezultatet e zbatimit të VKM-së nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbjetet e Tyre”, pra nuk ka të dhëna mbi sasinë e ambalazheve të mbetjeve në total për gjithë territorin e vendit.
19. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka të dhëna të sakta se sa kompani që merren me grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve të plastikës kanë qenë aktive për periudhën 2017-2020.

Konkluzione

13. Mos raportimi i të gjitha NJQV-ve në AKM lidhur me sasinë e mbetjeve plastike të gjeneruara në territorin e tyre, sjell që AKM të mos grumbullojë të gjitha statistikave të mbetjeve plastike në nivel kombëtar. Si rrjedhojë, dhe MTM nuk ka të dhëna të sakta dhe të plota mbi sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe të menaxhuara në nivel kombëtar përfshirë dhe mbetjet plastike. Saktësia dhe plotësia e të dhënave është e rëndësishme sepse mbështetur mbi to MTM duhet të hartojë politika në nivel qendror për menaxhimin e mbetjeve plastike. Të dhënat e pasakta dhe të paplota mund të rezultojnë në hartim politikash të gabuara apo në mos hartim politikash për të përfituar një menaxhim efektiv të mbetjeve në nivel kombëtar. Një tjetër arsye e rëndësishme është edhe se AKM ka të dhëna lidhur me gjenerimin e mbetjeve plastike vetëm nga kompanitë që janë pajisur me kod unik sipas VKM-së nr. 229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”. Rezulton se deri në fund të 2020 janë pajisur me kod unik 171 subjekte private nga 286 në total. Pra, mos pajisja me kod unik e të gjitha subjekteve që operojnë sot në tregun shqiptar sjell rrjedhimisht mangësi në raportimin e të dhënave që këto subjekte dërgojnë në AKM. Mos raportimi nga të gjitha Bashkitë në AKM vjen si

¹⁰⁰ Burimi MTM, email date 05.05.2021 ora 17:35

¹⁰¹ Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 66 - pika 4

- pasojë e kushteve dhe mungesës së infrastrukturës së ndarjes së mbetjeve në burim nga ana e Bashkive, problem i trajtuar më sipër gjatë Raportit të Auditimit.
14. Arsyeja kryesore për mos pasjen e të dhënave lidhur me sasinë e riciklimit të mbetjeve plastike dhe mos publikimin e tyre në Raportet e Gjendjes në Mjedis nga ana e AKM është se të gjitha Bashkitë nuk kanë raportuar asnjëherë mbi sasinë totale të riciklimit të mbetjeve plastike si dhe mangësive të zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore lidhur me raportet e vetmonitorimit të cilat duhet të kenë të dhëna mbi sasinë e riciklimit të mbetjeve plastike. Nga shqyrtimi i dokumentacioneve që grupi i auditimit i bërë disa prej subjekteve private që disponojnë leje mjedisi për përpunimin/riciklimin e plastikës rezultoi se disa prej tyre nuk respektojnë kushtet dhe kriteret e vendosura në lejet përkatëse të mjedisit duke mos dërguar raportet e vetmonitorimit në AKM. Mos dërgimi i raporteve të vetmonitorimit nga të gjitha subjektet që disponojnë leje mjedisi për përpunimin/riciklimin e plastikës i të dhënave lidhur me plastikën çënon saktësinë e të dhënave që AKM publikon në raportet e saj zyrtare.
 15. Nga të dhënat e grumbulluara nga AKM, raportimi mbi sasinë e ambalazheve të mbetjeve nuk bëhet nga asnjë NJQV. AKM nuk ka rezultatet e përqindjeve të grumbullimit të mbetjeve të ambalazheve dhe nuk harton dot një përmbledhje për ta përfshirë në Raportin e Gjendjes në Mjedis. Gjithashtu rezultoi se MTM nga ana e saj nuk ka marrë masa për vënien në zbatim të kësaj VKM-je. Pra, mund të themi se, VKM nr. 177 datë 6.3.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre” edhe pse e miratuar para 8 viteve ende nuk zbatohet duke çënuar dukshëm sasinë dhe cilësinë e të dhënave mbi mbetjet plastike totale të gjeneruara dhe menaxhuara në vendin tonë.
 16. NJQV-të nuk raportojnë në AKM mbi sasinë e qeseve plastike mbajtëse në qarkullim në territorin e tyre në mos përputhje me VKM nr. 232 datë 26.04.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 177, datë 6.3.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”. Kjo sjell që AKM të mos marrë informacion mbi sasinë e qeseve plastike mbajtëse, në qarkullim në territorin e vendit dhe MTM në rolin e përgjegjës për zbatimin e detyrimeve që lindin nga kjo VKM.

Rekomandime

12. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa kundrejt të gjithë subjekteve private të cilat operojnë në aktivitete të tilla si grumbullimi, transferimi dhe riciklimi i mbetjeve plastike për të bërë të mundur që të gjitha subjektet të raportojnë rregullisht në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Qershor 2022 dhe në vazhdimësi

13. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në përputhje me VKM nr. 177, datë 6.3.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 9, të krijojë një “data base” lidhur me të dhëna e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre dhe ta vendosë në dispozicionin e publikut.

Qershor 2022

14. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të sigurojë çdo vit informacion të detajuar dhe të përditësuar lidhur me subjektet private të cilat operojnë në sektorin e mbetjeve plastike (grumbullim, transferim, riciklim etj.).

Qershor 2022 dhe në vazhdimësi

4.3.2 A janë hartuar raporte monitorimi mbi zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve ku përfshihen dhe mbetjet plastike?

Statistikat e Mbetjeve

Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë detyrimin ligjor të plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre dhe të raportojnë në AKM.¹⁰²

Detyrim ligjor për raportim kanë edhe personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë aktivitetin e tyre për menaxhimin e integruar të mbetjeve, mbajnë dhe përditësojnë të dhënat për mbetjet sipas përcaktimeve në: lejen e mjedisit për krijuesin e mbetjeve, licencën e transportit, licencën e tregtarit/agjentit, lejen e mjedisit për çdo lloj operacioni të trajtimit të mbetjeve. Këto të dhëna çdo fillim viti i vihen në dispozicion AKM në bazë të kërkesës së saj me shkrim.¹⁰³ Përveç tyre në AKM raportojnë edhe Ministria përgjegjëse për bujqësinë, ministria përgjegjëse për Infrastrukturën /transportin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për industrinë plotësojnë formatin e raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve dhe t'a dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit brenda datës 10 shkurt të çdo viti¹⁰⁴.

AKM mbledh, mban dhe përditëson statistikën për mbetjet sipas përcaktimeve ligjore, në bazë të të dhënave të grumbulluara, të cilat i raporton në ministri, brenda datës 28 shkurt të çdo viti.¹⁰⁵

VKM Nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e Statistikave të Mbetjeve” është miratuar në vitin 2015 por i ka filluar efektet ligjore në 1 Janar të vitit 2019, që do të thotë se në fillim të vitit 2020 duhej të ishte raportimi i parë mbi kërkesat e VKM nr.687/2015 për statistikën e mbetjeve në vendin tonë.

Të dhënat mbi grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim

- Çdo Njësi e Qeverisjes Vendore [NJQV] duhet të raportojë në mënyrë periodike, brenda datës 31 Janar të çdo viti, të dhënat për grumbullimin e rrymave të mbetjeve (Letër/karton; Metal; **Plastikë**; Qelq) në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.¹⁰⁶
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit i përpunon të dhënat në nivel kombëtar për sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar dhe objektivat e arritur, i regjistron ato në regjistrin e krijuar për këtë qëllim, i pasqyron në Raportin e Gjendjes së Mjedisit dhe ia raporton Ministrisë brenda datës 28 shkurt të çdo viti.¹⁰⁷
- Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit duhet të raportojë çdo vit në Këshillin e Ministrave për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në formatin e përcaktuar nga ministri;¹⁰⁸
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të përgatitë çdo tre vjet një raport për zbatimin e ligjit Nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, dhe këto raporte duhet të publikohen në faqen zyrtare të ministrisë dhe i vihen në dispozicion publikut;¹⁰⁹
- Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve bashkërendon detyrat e ministrive për menaxhimin e integruar mjedisor të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë. Ai kryesohet nga Zëvendësministri i Mjedisit dhe ka për detyrë që çdo fund viti, të paraqesë për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në shkallë vendi;¹¹⁰

¹⁰² VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e Statistikave të Mbetjeve”, pika 4

¹⁰³ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 55

¹⁰⁴ VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, shtojca 2

¹⁰⁵ VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e Statistikave të Mbetjeve”, pika 6

¹⁰⁶ VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim“, kreu VIII- pika 1

¹⁰⁷ VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim“, kreu VIII- pika 2

¹⁰⁸ Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 11 - pika 6

¹⁰⁹ Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 66 – pika 1 dhe pika 4

¹¹⁰ Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 15 – pika 2

Raportimet e NJQV-ve në AKM

Në zbatim të nenit 60 të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, AKM mban dhe përditëson statistikave për krijimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve që raportojnë NJQV-të mbi rrymat e mbetjeve të gjeneruara në territorin e tyre. Në zbatim të Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe akteve nënligjore, AKM ka ngritur bazën e të dhënave të mbetjeve në nivel kombëtar. Kjo bazë të dhënash përmban të gjitha rrymat e mbetjeve sipas Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve. Për sa i takon statistikave të mbetjeve përfshirë këtu dhe mbetjet plastike, referuar detyrimeve të nenit 60 dhe VKM-së 687 sipërcituar, situata paraqitet si më poshtë:

*Për vitin 2017,*¹¹¹ AKM ka grumbulluar informacionin mbi rrymat e mbetjeve të prodhuara në territorin e tyre nga **49 bashki kundrejt 61 bashkive** në total. Rezulton se për vitin 2017 nuk kanë raportuar në AKM 12 bashki (Klos, Divjakë, Tepelenë, Përmet, Has, Tropojë, Kurbin, Malësi e Madhe, Kamëz, Vorë, Selenicë, Himarë).

*Për vitin 2018,*¹¹² AKM i ka grumbulluar statistikave të mbetjeve bazuar në nenin 60 të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM-së nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”. Siç është theksuar më lart kjo VKM edhe pse është miratuar në vitin 2015 efektet ligjore duhet ti fillonte në 1 Janar të vitit 2019, por AKM ka filluar të kërkojë nga NJQV-të të raportojnë sipas kërkesave të saj që në vitin 2018. Rezulton që *për vitin 2018*, AKM ka grumbulluar të dhëna nga **55 bashki kundrejt 61 bashkive** në total. Nuk kanë dërguar asnjë informacion në AKM 6 bashki (Peqin, Has, Kurbin, Kamëz, Kavajë, Rogozhinë).

*Për vitin 2019,*¹¹³ vit në të cilin VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve” kishte hyrë në fuqi, AKM ka grumbulluar të dhëna nga **48 bashki nga 61 bashki** në total. Rezulton që në vitin 2019 nuk kanë raportuar në AKM lidhur me sasinë e mbetjeve të prodhuara në territorin e tyre 15 bashki (Durrës, Belsh Peqin, Fier, Divjakë, Gjirokastrë, Kukës, Has, Tropojë, Kurbin, Vorë, Rogozhinë, Himarë, Konispol dhe Delvinë). Nga Bashkitë objekt auditimi ajo e Elbasanit dhe e Vlorës raportojnë rregullisht në AKM brenda afateve të përcaktuara në VKM nr.687/2015, ndërsa bashkia e Tiranës nuk ka raportuar rregullisht. Në vlerësimin e bërë nga AKM rezulton se ndarja e mbetjeve në burim nuk kryhet në nivel kombëtar dhe të dhënat e dërguara nga bashkitë janë në bazë të llogaritjeve të sasisë totale të harxhuar¹¹⁴. Siç mund të shikohet më lart, numri i bashkive që kanë raportuar në AKM të dhënat për sasinë e mbetjeve të gjeneruara në territorin e tyre ka luhatur nga viti në vit, kjo do të thotë se bashkitë vazhdojnë të mos jenë të përgjegjshme në përmbushjen e detyrimeve ligjore që ato kanë. Në përfundim të gjithë problematikave që ka grumbullimi i statistikave mbi mbetjet plastike dhe besueshmëria e tyre rezulton se: MTM si institucioni më i lartë dhe me përgjegjësinë kryesore për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve në nivel kombëtar, nuk ka mbikqyrur procesin e zbatimit, nuk ka bërë të mundur ngritjen e mekanizmave të bashkëpunimit me NJQV me qëllim mbajtjen e tyre në dijeni për zhvillimet në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, marrjen nga ana e tyre të informacionit lidhur me rishikimin e

VKM Nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, pika 8

¹¹¹ Raporti i Gjendjes në Mjedis – 2017/Statistikave të mbetjeve

¹¹² Raporti i Gjendjes në Mjedis – 2018/Statistikave të mbetjeve

¹¹³ Raporti i Gjendjes në Mjedis – 2019/Statistikave të mbetjeve

¹¹⁴ Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2019, fq 211.

progresit të bërë në zbatim të të gjithë kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve përfshirë edhe mbetjet plastike.

Të dhënat mbi sasinë e mbetjeve plastike të gjeneruara dhe të menaxhuara do të vazhdojnë të jenë problem deri në momentin që NJQV të arrijnë të sigurojnë, ndarjen e mbetjeve në burim, grumbullimin e diferencuar dhe peshimin e sasisë së mbetjeve sipas rrymave në momentin dërgimit të tyre në landfill, incenerator apo vendgrumbullim. Një ndër komponentët kryesorë të zbatimit të legjislacionit për MIM është edhe monitorimi i zbatimit të VKM-së nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”. MTM si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj VKM-je, mbështetur në të dhënat që grumbullon AKM nga NJQV-të, të cilat i përcjell në ministri, duhet të hartojë raportin për zbatimin e VKM-së 418/2014 si pjesë e raportit për zbatimin e ligjit për MIM.

Për periudhën objekt auditimi rezulton që nga ana e MTM-së nuk është përgatitur asnjë raport monitorimi në rolin e përgjegjësit të mbikëqyrjes së zbatimit të kërkesave të VKM-së nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, raport i cili duhet të jetë pjesë integrale e raportit për zbatimin e Ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Theksojmë se, kjo VKM ka objektiv përcaktimin e afateve dhe masave për grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes këtyre proceseve: Optimizimit të grumbullimit të mbetjeve; sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim; promovimit të ripërdorimit të produkteve; përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit; përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve¹¹⁵.

Për të bashkërenduar detyrat e ministrive për menaxhim të integruar mjedisor të mbetjeve, krijohet Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, si organizëm ndërministror, në nivel zëvendësministrash. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve [KMIM] ndër të tjera shqyrton, analizon dhe propozon masa të domosdoshme, ligjore dhe administrative, për administrimin e mbetjeve mbështetur në katër shtyllat kryesore të politikës: planifikim, edukim, burime dhe legjislacion.¹¹⁶ KMIM, me anë të anëtarëve të tij pranë ministrive, siguron që çdo ministri të ketë një politikë të përbashkët dhe të unifikuar për administrimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit.¹¹⁷ KMIM duhet të garantojë një konsultim ndërministror, gjatë të cilit trajtohen administrimi i mbetjeve dhe mjedisi në një nivel të lartë politik, duke siguruar që këto çështje të merren parasysh nga të gjitha ministrinë.¹¹⁸ Komiteti mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj për të shqyrtuar e për të miratuar dokumentet dhe aktet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, dhe paraqet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në shkallë vendi.¹¹⁹

MTM pranon se nuk ka raporte të hartuara për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe deklaron se raportimi bëhet verbal si për progresin e bërë në menaxhimin e integruar të mbetjeve ashtu edhe për planifikimet e aktiviteteve në vazhdim.¹²⁰ Edhe pse për periudhën objekt auditimi MTM nuk ka përgatitur asnjë raport monitorimi mbi

¹¹⁵ VKM 418 Nr.418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” kreu IX pika 3

¹¹⁶ VKM Nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, pika 4.

¹¹⁷ VKM Nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, pika 5.

¹¹⁸ VKM Nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, pika 6.

¹¹⁹ VKM Nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, pika 8 dhe pika 9.

¹²⁰ Pyetësori i zhvilluar në MTM

zbatimin e legjislacionit për MIM ajo deklaroi se “zbatimi i legjislacionit nuk është në nivelin e dëshiruar”.¹²¹ Në këndvështrimin e MTM-së arsytet e moszbatimit janë:

- mungesë e infrastrukturës në vend;
- pamjaftueshmëri financiare për të ngritur këtë infrastrukturë;
- pamjaftueshmëri të kapaciteteve njerëzore për të realizuar inspektimin dhe monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit.

Gjetje

20. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raportuar në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 11 pika 6.
21. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka monitoruar dhe nuk ka përgatitur asnjë raport në zbatim të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 66 pika 1.
22. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve nuk ka paraqitur për shqyrtim pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor në shkallë vendi, për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, për periudhën 2017-2020, në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 15 pika 2.

Konkluzione

17. Mos raportimi në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, tregon që MTM nuk e ka monitoruar zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve ku mbetjet plastike janë një nga rrymat. Kjo sjell që, MTM nuk ka informacion mbi shkallën e zbatimit të kuadrit ligjor lidhur me menaxhimin e mbetjeve, në të cilat bëjnë pjesë edhe mbetjet plastike. Në këto kushte ku nuk ekziston asnjë raport monitorimi mbi zbatimin e PKMM dhe Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, grupi auditimit arrin në konkluzionin që MTM ka dështuar në zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve përfshirë këtu edhe mbetjet plastike si një nga katër rrymat e mbetjeve të ngurta. Mos realizimi i procesit të monitorimit sjell që niveli i zbatimit të legjislacionit të jetë i ulët apo zbatimi të mos jetë efektiv.
18. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve nuk ka funksionuar në mënyrë efektive në përmbushje të detyrimeve që i ka përcaktuar Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” dhe VKM nr. 967, datë 25.10.2013 “Për Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”. Duke mos raportuar periodikisht në Këshillin e Ministrave, tregon që ky Komitet nuk ka analizuar situatën lidhur me administrimin e mbetjeve mbështetur në katër shtyllat kryesore të SKMM: planifikimi, edukimi, financimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor, si dhe nuk është siguruar unifikimi i një politike të përbashkët ndërministrorë për administrimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. MTM në cilësinë e Kryetarit të KMIM (KMIM drejtohet nga zv/ministri i Mjedisit) deklarohen se “Raportimet e Komitetit në KM bëhen në mënyrë verbale”.¹²² Kjo bie në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 967/2013, ku në asnjë pikë nuk përcaktohet raportimi verbal dhe është shumë e qartë se Komiteti duhet të paraqesë për shqyrtim dhe miratim raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në shkallë vendi. Mos përgatitja e raporteve vjetore nga KMIM tregon se

¹²¹ Përgjigjet e pyetësorit të realizuar në MTM

¹²² Përgjigjet e pyetësorit të zhvilluar në MTM

edhe një strukturë tjetër (përveç MTM-së) përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për MIM nuk ka funksionuar, duke e çënuar edhe më shumë efektivitetin e zbatimit të legjislacionit deri në mos zbatim të tij.

Rekomandime

15. Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme dhe të raportojë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve miratuar me VKM nr. 418, datë 27.05.2020.

Qershor 2022 dhe në vazhdimësi

16. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të përgatitur raportin e zbatimit të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

Qershor 2022 dhe çdo 3 vjet

17. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve çdo fund viti të paraqesë në Këshillin e Ministrave raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në përputhje me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 15 pika 2.

Qershor 2022 dhe në vazhdimësi

5 PËRMBLEDHJA

Auditimi me temë “Menaxhimi i mbetjeve plastike”, ka mbuluar periudhën 2017-2020 dhe është fokusuar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si ministria përgjegjëse në hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me menaxhimin e mbetjeve plastike si dhe në Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë duke qenë se institucionet e vetëqeverisjes vendore kanë një sërë përgjegjësish lidhur me menaxhimin e mbetjeve plastike.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë qenë efektive sa i përket menaxhimit të mbetjeve plastike për periudhën 2017-2020. Mangësi të theksuara janë vërejtur në hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor e rregullator të nevojshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike. MTM nuk ka hartuar Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve dhe nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, ndërsa Bashkia Tiranë dhe Vlorë nuk kanë hartuar dhe miratuar Planet Vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk kanë krijuar infrastrukturën e nevojshme për të bërë të mundur grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim dhe objektivi kryesor për përdorimin dhe riciklimin e plastikës me 22.5 % kundrejt volumit total që krijohet në këto bashki nuk është arritur dhe nuk do të arrihet për aq kohë sa infrastruktura do të jetë kjo që është. Aktivitetet informuese dhe edukuese që Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë do të duhej të arrinin nëpërmjet kompanive private që kryejnë shërbimin e pastrimit të qytetit dhe që kanë detyrimin për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve nuk janë arritur. MTM dhe AKM nuk kanë të dhëna të plota dhe të sakta në nivel kombëtar, mbi sasinë e mbetjeve plastike që gjenerohen dhe riciklohen në Shqipëri. Të dhënat mbi sasinë e mbetjeve plastike të gjeneruara dhe të menaxhuara do të vazhdojnë të jenë problem deri në momentin që NJQV të arrijnë të sigurojnë, ndarjen e mbetjeve në burim, grumbullimin e diferencuar dhe peshimin e sasisë së mbetjeve sipas rrymave në momentin dërgimit të tyre në landfill, incenerator. Në këtë auditim grupi i auditimit është fokusuar në auditimin e efektivitetit të procesit të menaxhimit të mbetjeve plastike duke parë aspekte të hartimit, përditësimit, zbatimit dhe monitorimit të kuadrit ligjor si dhe efektivitetin në edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me

ndarjen e mbetjeve dhe pasojat e mbetjeve plastike. Sa i përket gjetjeve më të rëndësishme ka rezultuar se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve dhe nuk ka hartuar dhe nuk ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave masat e nevojshme që çdo person juridik ose fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 16 pika 1. Ndërsa Bashkitë Tiranë dhe Vlorë nuk kanë hartuar dhe miratuar Planet Vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që kanë nën juridiksion. Mungesa e Planeve Vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve (e cila ka ardhur edhe për mungesë të Planeve Rajonale) nga ana e Bashkive Tiranë dhe Vlorë sjell mangësi të theksuara në menaxhimin e mbetjeve në tërësi por dhe atyre plastike në veçanti. Plani Vendor i menaxhimit të mbetjeve është dokumenti kryesor në nivel vendor dhe bazuar në të duhet më tej hartohen edhe rregullore për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve.

Në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nuk janë përcaktuar afatet e vlerësimit dhe rishikimit të Programeve të Parandalimit të krijimit të mbetjeve në mos përputhje me nenin 30 pika 1 të Direktivës së BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet. Referuar Direktivës së BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet” këto Programe duhen rishikuar të paktën çdo 6 vjet. Objektivi specifik i vendosur në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1, gërma c, për t’u arritur nga NJQV-të për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike 22.5% të peshës së mbetjeve nuk është arritur nga asnjë prej Bashkive Tiranë, Elbasan dhe Vlorë.

Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë marrë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu IV pika 1. Afatet ligjore për ngritjen e infrastrukturës së duhur që ofron grumbullimin e diferencuar të mbetjeve kanë përfunduar pa u përmbushur. Kontratat që Bashkitë Elbasan dhe Vlorë kanë lidhur me kompanitë private që operojnë në këtë fushë nuk janë bazuar në Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Kontratat e shërbimit të pastrimit për të tre Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk parashikojnë në specifikimet teknike grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në përputhje me Ligjin 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim.

Lidhur me nismat sensibilizuese, MTM nuk ka ndërmarrë nisma informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre. Në Bashkinë Tiranë programi i Edukimit Ambjental dhe Edukimit të Publikut është realizuar pjesërisht vetëm nga një kompani (E. T.) nga pesë të tilla që ofrojnë shërbimin e pastrimit në qytetin e Tiranës në kundërshtim kjo me kushtet e kontratës së lidhur me kompanitë kontraktore. Në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan kompanitë kontraktore që mbulojnë shërbimin e pastrimit nuk kanë hartuar Programet e Edukimit të Publikut në shkelje të detyrimeve kontraktore, si rezultat nuk kanë ndërmarrë nisma informuese, ndërgjegjësuuese dhe edukuese lidhur me mbetjet (përfshirë dhe mbetjet plastike) dhe reduktimin e tyre. Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë marrë asnjë masë për të informuar përdoruesit e ambalazheve dhe në mënyrë të veçantë, konsumatorët për zbatimin e detyrimeve të VKM-së nr. 177, datë 6.3.2012, 2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XIII.

Lidhur me saktësinë e të dhënave që janë publikuar nga AKM në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (2017, 2018, 2019) lidhur me sasinë totale të mbetjeve plastike që prodhohen në Shqipëri nuk janë të sakta dhe të plota sepse jo të gjitha Bashkitë kanë raportuar çdo vit dhe jo të gjitha subjektet private që gjenerojnë mbetje plastike raportojnë rregullisht. Gjithashtu, AKM nuk ka të dhëna të sakta dhe nuk ka publikuar në RGJM (2017-2019) mbi sasinë e riciklimit të mbetjeve plastike. MTM nuk ka të dhëna mbi rezultatet e zbatimit të VKM-së nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, pra nuk ka të dhëna mbi sasinë e ambalazheve të mbetjeve në total për gjithë territorin e vendit. MTM nuk ka raportuar në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve.

Lidhur me rekomandimet, grupi i auditimit ka dhënë një sërë rekomandimesh si për masa organizative ashtu edhe për përmirësime ligjore si për shembull në rastin e përcaktimit të afateve për rishikimin dhe vlerësimin e Programit të Parandalimit të krijimit të mbetjeve. Gjithashtu, grupi i auditimit ka dhënë rekomandime për hartimin dhe miratimin e Planeve Vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve për Bashkitë Tiranë dhe Vlorë si dhe për përmirësimin e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Rekomandime janë dhënë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik nga ana e Bashkive si dhe hartimin dhe lidhjen e kontratave të reja për shërbimin e pastrimit të qyteteve përkatëse në përputhje me Ligjin 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” duke përcaktuar qartë në specifikimet teknike vendosjen e konteinerëve të ndryshëm për të bërë të mundur grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim. Lidhur me publikimin dhe raportimin e të dhënave, grupi i auditimit ka adresuar një sërë rekomandimesh për AKM por dhe për MTM sa i përket raportimit që kjo e fundit duhet të bëjë në Këshillin e Ministrave për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

KONTROLI LARTE I SHTETIT